



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Universitetin e Tiranës (Rektorati)**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**(FINANCIAR)**

**UNIVERSITETI I TIRANËS (REKTORATI)**

**TIRANË, tetor 2025**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3 – 7</b>
1	<i>Përshkrimi i shkurtër i projekt të auditimit</i>	
2	<i>Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve</i>	
3	<i>Konkluzioni i përgjithshëm dhe opionioni i auditimit</i>	
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>7 - 12</b>
1	<i>Objektivat dhe qëllimi</i>	
2	<i>Identifikimi i çështjes</i>	
3	<i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese</i>	
4	<i>Përgjegjësitë e audituesve</i>	
5	<i>Kriteret e vlerësimit</i>	
6	<i>Standardet e auditimit</i>	
7	<i>Metodat e auditimit</i>	
8	<i>Dokumentimi i auditimit</i>	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>12 - 67</b>
1	<i>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim</i>	<i>12 – 13</i>
2	<i>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit</i>	<i>13 – 67</i>
2.1	<i>Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit</i>	<i>13 – 24</i>
2.2	<i>Auditimi i llogarive vjetore.</i>	<i>24 – 51</i>
2.3	<i>Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit</i>	<i>51 - 61</i>
2.4	<i>Vlerësimi i komponentëve të Auditit të Brendshëm</i>	<i>61 – 67</i>
<b>IV</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>67 – 72</b>

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:**

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 103/4, datë 01.02.2024 (i ndryshuar), i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 01.02.2024 deri në datën 10.05.2024, në subjektin “Universitetit të Tiranës (Rektorati)”, (në vijim UT), për periudhën nga 01.01.2021 deri në datën 31.12.2023, u krye auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së veprimtarisë dhe rregullshmërinë e operacioneve financiare të kryera nga ana e këtij institucioni, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me llogaridhënien vjetore, administrimin e fondeve buxhetore dhe zbatimin e procedurave të emërimit dhe largimit nga puna të arsimtarëve, aspektet e menaxhimit financiar dhe të vlerësimit të sistemeve të kontrollit, etj.

Universiteti i Tiranës është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe me rregullat e parashikuara në Statutin dhe në rregulloret e tij. Njësitë përbërëse gëzojnë personalitet juridik, sipas kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Statuti i miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.816 datë 26.12.2018.

Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron programe të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut. Ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Universiteti i Tiranës përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Njësitë kryesore janë fakultetet dhe institutet e kërkimit shkencor, ndërsa njësitë bazë të tij janë departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore. Njësitë e tjera janë struktura të krijuara nga Universiteti në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit. Njësitë e tjera janë njësi ndihmëse me karakter akademik, si dhe njësi ndihmëse me karakter administrativ, të cilat veprojnë në nivel rektorati dhe njësie kryesore. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel rektorati përcaktohen në këtë Statut. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel njësie kryesore përcaktohen në rregulloren përkatëse. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 8 njësi kryesore. Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme. Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Dekani i fakultetit/drejtori i institutit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të UT për periudhën e aktivitetit 2021-2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në funksion të rritjes së performancës së mësimdhënies.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionin nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.*
- *Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.*
- *Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023,*
- *Zbatimi i dispozitave ligjore mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.*
- *Prokurimi i fondeve publike.*

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 59,542 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të Universitetit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Autoritetet drejtuese administrative janë: Administratori i institucionit, administratori i njësisë kryesore.

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të UT-së, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet administrative dhe financiare.

Organe të tjera kolegiale janë: Rektorati, Dekanati dhe Këshilli i etikës.

Numri total efektiv me kohë të plotë i personelit të UT ku përfshihen personel akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është 1169 punonjës për vitin 2021, 1200 punonjës për vitin 2022 dhe 1228 punonjës për vitin 2023.

Financimi i UT kryhet nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta ku për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në masën 1,934,136,381 lekë , për vitin 2022 është në masën 2,016,766,605 lekë, ndërsa për vitin 2023 është në masën 2,385,963,177 lekë.

**e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.** Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të vprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar dhe formuluar 10 gjetje dhe 11 rekomandime masa organizative për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.**

- Për vitin 2022, komisioni i inventarizimit nuk ka përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve. Në vitin 2023 në UT nuk janë realizuar proceset e inventarizimit. Gjithashtu për vitet objekt auditimi nuk është konstatuar dhe verifikuar gjendja e lëndës djegëse në cisternat e karburantit në fund të çdo sezoni të ngrohjes për secilën nga kaldajat e UT dhe nuk është pasqyruar niveli i lëndës djegëse në depozitat e kaldajave dhe gjeneratorit;

- Nga auditimi i zbatimit të buxhetit, konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara të cilat reflektohen në përqindje të ulët realizimi. Në vitin 2023 realizimi i llogarisë 602 është 76%, në vitin 2023 llogaria 606 është realizuar në masën 71%, në vitin 2021 llogaria 231 është realizuar në masën 1,6%. Kjo tregon mungesë efience në arritjen e objektivave të miratuara për UT. Gjithashtu të pranishme janë dhe rialokimet të cilat evidentohen vit pas viti dhe granti i trashëguar. Nga viti nga viti 2021 kanë pasur grant të trashëguar të gjitha njësitë, përveç ISE, IFBZ dhe Institutit Konfuci. Nga vitit 2022 grant të trashëguar kanë pasur të gjitha njësitë, përveç Institutit Konfuci;

- Nga auditimi i llogarive vjetore, rezulton se lidhur me gjendjen e debitorëve të paraqitur në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, nga ana e Rektoratit dhe Universitetit të Tiranës, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e debitorëve të krijuar nga vitet 2010-2018, në vlerën 4,321,625 lekë;

- Periudha e hyrjes dhe regjistrimit të aseteve në aktivet e Universitetit të Tiranës është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të aseteve me qëllim përaftrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Financiare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivitetit.

**g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

- Organet Drejtuese të marrin masa për miratimin e PBA brenda afateve të përcaktuara dhe respektimin e radhës kronologjike dhe hierarkike të miratimit nga UT fillimisht si nga Senati, GMS, Bordi i Administrimit e së fundmi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

- Universiteti i Tiranë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa që:

*Strukturat përgjegjëse për programimin dhe planifikimin buxhetor të kryejnë analizat e nevojshme për një buxhet të suksesshëm, duke patur parasysh nevojat reale gjatë vitit buxhetor.*

*Planifikimin e përdorimit të të ardhurave për nevojat e institucionit në shërbim të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë së arsimit si dhe mbështetjen e kërkimit shkencor.*

*Vënien në përdorim të të ardhurave të mbartura, për zhvillimin e mëtejshëm të UT dhe realizimin e misionit të institucionit.*

- Rektori i UT në bashkëpunim me Senatit Akademik, Bordin e Administrimit si dhe strukturat e tjera përgjegjëse të marrë masat e nevojshme për analizimin, nxjerrjen e përgjegjësive dhe realizim të treguesve të planifikuar e të miratuar të buxhetit për fushën e Kërkimit Shkencor, duke e konsideruar si një fushë prioritare për UT.

- Administratori i UT në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe atë Juridike, të marrin masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite në vlerën **4,321,625 lekë**. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të verifikohet dhe evidentohet realisht statusi apo mundësia për arkëtim të detyrimit dhe më pas të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

- Universiteti i Tiranës (strukturat përgjegjëse), të marrin masa për përmbylljen e procedurave dhe pajisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e regjistruara në llogarinë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, me qëllim formalizimin e marrëdhënies së Universitetit të Tiranës dhe objekteve në pronësi.

- Administratori i UT në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të parashikojnë fonde për kryerjen e procesit të rivlerësimit të asetëve nga subjekte të licencuara, me qëllim përfrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

- Administratori i UT të marrë masa për:

*Kryerjen e inventarëve të paktën një herë në vit, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të fushës, me qëllim kryerjen e inventarizimit me cilësi, pasqyrim të drejtë të procesit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve.*

*- Nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimi e akviteve, të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, evidentimin e vendndodhjes dhe groposjes së tyre, djegien, etj., shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar në mënyrë rigorozë procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimin e materialeve.*

- Bordi i Administrimit të Universitetit të Tiranës të marrë masa që raportet e auditimit të brendshëm të shqyrtohen në kohë, duke respektuar përcaktimet ligjore në fuqi.

- Drejtoria e Auditit të marrë masa që të krijojë dosjen e përhershme të auditimit, si dhe në zbatim të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë si dhe të arkivohen dosjet e auditimit në arkivin e institucionit..

- Rektori i Universitetit në bashkëpunim me Administratorin e UT, të marrin masa për :

*Hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështje financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performancë dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.*

*Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.*

*Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.*

## I.1. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit.

### **Opinion pakualifikuar mbi pasqyrat financiare:**

Audituesit e pavarur të KLSH-së, kanë audituar pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara të Universitetit të Tiranës dhe dokumentacionin financiar për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2023 dhe japin opinion për pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara të vitit 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të flukseve monetare, të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, pasqyrat statistikore dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduara të subjektit UT paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31.12.2022 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar".

## I.1. Opinioni i Auditimit.

### **a- Opinioni mbi pasqyrat financiare:**

Audituesit e pavarur të KLSH-së, kanë audituar pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduar të Universitetit të Tiranës (Rektorati) dhe dokumentacionin financiar për periudhën ushtrimore 01.01.2021 - 31.12.2023, duke dhënë japin opinion vetëm për pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduar të vitit 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të flukseve monetare, të ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto, pasqyrat statistikore dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare individuale dhe të konsoliduar të subjektit UT (Rektorati) paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31.12.2023 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar", të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin".*

### **Baza për opinion:**

Ne kemi audituar veprimtarinë e Universitetit të Tiranës në mbështetje të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe ISSAI 17002. Auditimi u krye në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 246, datë 29.12.2022, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në INTOSAI-P 10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130- "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të

Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e *opinionit të pakualifikuar*.

Nën gjykimin profesional të audituesit është marrë në konsideratë pragu i materialitetit për vitin 2023 (në masën 0.7-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar) në vlerën 59,542 mijë lekë për shpenzimet e raportuara në pasqyrat financiare të konsoliduar dhe 7,013 mijë lekë për shpenzimet e raportuara në pasqyrat financiare individuale.

*Për llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm"* rezulton se nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e debitorëve të krijuar nga vitet 2010-2018, në vlerën 4,321,625 lekë.

Gjithashtu në lidhje me pronat e kaluara në administrim të UT në përputhje me VKM nr. 430, datë 02.07.2014, i ndryshuar, nuk janë realizuar procedurat e regjistrimit të pasurisë dhe pajisjes me certifikatat e pronësisë për objektet godinë e pronësie, por është në proces regjistrimi të tyre, konkretisht për godinën e Rektoratit dhe Godinën Liria.

Në llogarinë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*", rezulton e mbartur vlera prej 1,477,393 lekë, e cila përfaqëson garancitë 5% të punimeve të projekteve të realizuara gjatë viteve 2013 – 2021 dhe për të cilat nuk ka informacion se përse janë mbajtur këto fonde për një periudhë disa vjeçare pas përfundimit të projektit.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së*", në zbatim të programit të auditimit nr.103/4 , datë 01.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 01.02.2024 deri më 10.05.2024 në Universitetin e Tiranës u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2021- 31.12.2023 nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K.GJ, *përgjegjës i grupit të auditimit*;
2. E.SH, *audituese*;
3. A.Z, *auditues*;
4. A.S, *auditues*;
5. R.A, *auditues*;
6. A.M, *audituese*;
7. S.Z, *auditues*.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

**1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.** Objekt i këtij auditimi është auditimi përputhshmërie dhe financiar, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 "*Kriteret e vlerësimit*". Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre. Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga

ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

**2. Identifikimi i çështjes.** Referuar programit të auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Veprimtaria e Universitetit të Tiranës (rektorati).
- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.
- Auditimi i llogarive vjetore.
- Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të fakultetit, janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, për përdorimin e burimeve financiare me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së UT-së, në drejtim të mirë administrimit të fondeve.

**4. Përgjegjësitë e audituesve.** Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e zbatimit të buxhetit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "*Për buxhetin e vitit 2021*"; Ligji nr. 115/2021, datë 25.11.2021 "*Për buxhetin e vitit 2022*"; Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 "*Për buxhetin e vitit 2023*"; Udhëzimet e MFE "*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm*"; Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.07.2018 "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*"; i ndryshuar.

- Në fushën e zbatimit të pagave: Ligjin Nr.80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; Statuti i Universitetit të Tiranës miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit nr.816 datë 26.12.2018; VKM-së nr.656 datë 31.10.20218 "*Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisve të qeverisjes qendrore*" i ndryshuar, (me VKM nr. 559 datë 31.07.2019 e VKM nr.612 datë 29.07.2020).

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*"; VKM nr. 248, date 10.4.1998 "*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore*

dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar .

- Në fushën e prokurimeve publike; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

**6. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.** Auditimi është kryer në përputhje me ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**7. Metodatat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

**8. Dokumentimi i auditimit.** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të

grumbulluara, nga grupi i auditimit janë mbajtur akt-konstatimet të cilat u dorëzuar në zyrën e protokollit UT në datë 10.05.2024, e cila korrespondon me datën e mbylljes së punës në terren sipas programit të auditimit. Nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshtitë të cilat pasi u analizuan me kujdes dhe profesionalizim nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë ato kundërshti të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion, u përgatit dhe u dërgua në subjekt Projekt raporti i Auditimit me shkresën nr. 103/20 prot, datë 8.8.2024 për njohje dhe paraqitjen e kundërshtive rreth gjetjeve të tij.

Në përfundim të afatit 30 ditorë, nga subjekti i audituar (Universiteti i Tiranës), me shkresën nr. 197/50 prot, datë 6.9.2024 dhe nr. 197/51, datë 6.9.2021, janë paraqitur kundërshtitë mbi Projekt raport Auditimit, të cilat pasi u analizuan me kujdes, profesionalizëm dhe paanshmëri nga grupi i auditimit, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Universiteti i Tiranës është person juridik publik, i njohur me ligj si i tillë. Ai organizohet dhe funksionon në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, si edhe me rregullat e parashikuara në Statutin dhe në rregulloret e tij. Njësitë përbërëse gëzojnë personalitet juridik, sipas kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Statuti i miratuar me urdhrin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.816 datë 26.12.2018.

Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron programe të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti i Tiranës është një universitet publik që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktorale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publi: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut. Ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale. Universiteti i Tiranës përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Njësitë kryesore janë fakultetet dhe institutet e kërkimit shkencor, ndërsa njësitë bazë të tij janë departamentet dhe qendrat kërkimore-shkencore. Njësitë e tjera janë struktura të krijuara nga Universiteti në përputhje me misionin dhe veprimtaritë e institucionit, të cilat ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit. Njësitë e tjera janë njësi ndihmëse me karakter akademik, si dhe njësi ndihmëse me karakter administrativ, të cilat veprojnë në nivel rektorati dhe njësie kryesore. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel rektorati përcaktohen në këtë Statut. Njësitë ndihmëse që veprojnë në nivel njësie kryesore përcaktohen në rregulloren përkatëse. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 8 njësi kryesore. Organi më i lartë drejtues akademik i Universitetit është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë Asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme. Autoritetet drejtuese akademike janë: Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore, drejtuesi i njësisë bazë. Rektori është autoriteti më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Dekani i fakultetit/drejtori i institutit është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj. Drejtuesi i njësisë bazë është drejtuesi i departamentit ose i qendrës kërkimore-shkencore. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të shtetit.**

Universiteti i Tiranës kryen aktivitetin duke u bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë”, në Statutin e UT të vitit 2018, në Rregulloren e UT miratuar me Vendim të Senatit Akademik si dhe në strategjinë e zhvillimit të institucionit. Autoritetet dhe Organet Drejtuese të UT përfshijnë Rektorin, Senatin Akademik, Rektoratin, Dekanatin, Këshillin e Etikës, Komisionet, Administratorin dhe Bordin e Administrimit.

Burimet e financimit të Universitetit të Tiranës sipas nenit 109, të ligjit nr.80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” janë si më poshtë:

- a. *Buxheti i Shtetit;*
- b. *Pagesat e studentëve për arsimim;*
- c. *Të ardhurat për shërbimet e kryera;*
- d. *Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta*
- e. *Donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi.*

Fondet e buxhetit të shtetit shpërndahen në formën e grantit që mund të jetë granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, granti i mësimdhënies, granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

#### **- PBA**

Programi afat-mesëm i buxhetit të Universitetit të Tiranës përbëhet nga PBA e Rektoratit dhe e të gjitha njësive vartëse të tij. UT, sipas nenit 108 të ligjit 80/2015 pika 2, harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit.

PBA 2021,2022,2023, për kodin e programit 09450

(në lekë)

Nr.	Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
		Programuar	Celur	Programuar	Celur	Programuar	Celur
1	Paga, art. (600)	1,511,728,708	1,299,940,772	1,514,815,634	1,222,995,284	1,534,598,160	1,590,618,710
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës., art. (601)	234,277,052	213,199,062	240,727,742	203,039,201	243,756,961	254,636,215
3	Shpenzimet operative, art. (602)	200,000,000	246,730,584	200,000,000	296,810,951	200,000,000	284,500,544
4	Kuatizacione (605)	0	0	0	0	0	402,026,890
4	Bursa për studentët, art. (606)	357,361,000	335,724,601	387,000,000	365,322,122	364,323,702	403,559,387
5	Investime, art. (231)	110,739,000	26,898,460	120,397,000	43,257,520	77,576,799	57,479,714
6	Garanci punimesh (466)		13,197,240		1,199,730		1,796,130
TOTAL BUXHETI		2,414,105,760	2,135,690,719	2,462,940,102	2,132,624,808	2,420,255,622	2,592,590,691

Burimi: UT, përpunuar nga Grupi i Auditimit

PBA sipas kod programit 09450, llogaria 600 “Pagat” është programuar për vlerën 1,511,728 lekë dhe miratuar në buxhetin vjetor për 1,299,940,772 lekë për vitin 2021. Për vitin 2022 është programuar për vlerën 1,514,815 lekë dhe miratuar në buxhetin vjetor për 1,222,995,284 lekë. Për vitin 2023 është programuar për vlerën 1,534,598 lekë dhe miratuar në buxhetin vjetor për 1,590,618,710 lekë.

PBA sipas kod programit 09450, llogaria 601 “Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore” është programuar për vlerën 234,277,052 lekë dhe miratuar në buxhetin vjetor për 213,199,062 lekë për vitin 2021. Për vitin 2022 është programuar për vlerën 240,727,742 lekë dhe miratuar në buxhet për 203,039,201 lekë. Për vitin 2023 është programuar për vlerën 243,756,961 lekë dhe miratuar në buxhetin vjetor për 254,636,215 lekë.

Nr.	Emërtimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
		Programuar	Çelur	Programuar	Çelur	Programuar	Çelur
1	Paga, art. (600)	-	-	-	-	-	-
2	Sigurimet shoq. dhe shëndetës., art. (601)	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzimet operative, art. (602)	-	21,655,844	-	41,856,602	-	48,354,112
4	Bursa për studentët, art. (606)	-	-	-	-	-	11,560,000
5	Investime, art. (230)	-	-	-	-	-	-
6	Investime, art. (231)	-	41,574,800	-	80,480,152	-	39,121,300
TOTAL BUXHETI		-	63,230,644	-	122,336,754	-	99,035,412

Burimi: UT përpunuar nga Grupi i Auditimit

PBA kod programi 09770 për të treja vitet subjekt auditimi nuk ka pasur parashikim për të në PBA, por vetëm në buxhetin vjetor.

#### - **Për vitin 2021:**

Më datë 07.06.2021, UT i dërgon fakulteteve dhe filialit shkresë për përgatitjen e PBA 2022-2024. Informacioni duhet të dërgohet brenda datës 2 korrik 2021 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më 13.07.2021 me shkresën nr. 3926 prot., MARS i dërgon Universitetit të Tiranës shkresën për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024. Projektbuxheti i përgatitur duhet të dërgohet brenda datës 15.08.2021 zyrtarisht në MASR dhe përmes E-mail. Më 13.08.2021 Universiteti i Tiranës dërgon PBA 2022-2024 MARS.

GMS: Në këtë vit nuk është organizuar asnjë mbledhje e GMS për miratimin e PBA.

- Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 08.07.2021 nr. 1507/4 prot.), Instituti i Studimeve Europiane (shkresa më 12.07.2021 nr. 1507/5 prot), Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (shkresa më 30.07.2021 nr. 1507/6 prot), Fakulteti i Drejtësisë (shkresa më 30.07.2021 nr. 1507/7 prot.,) Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 02.08.2021, nr. 1507/8 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2022-2024 jashtë afatit 02.07.2021 si është përcaktuar në shkresën e Rektoratit dërguar më 07.06.2021.

- Fakulteti i Ekonomisë nuk ka dërguar informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë shkresore.

Më datë 25.11.2021, me Vendimin nr.35, Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2022-2024 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.53 datë 26.11.2021 miratohet nga Bordi i Administrimit.

#### - **Viti 2022:**

Më 27.05.2022, nr.1629 prot., Universiteti i Tiranës i dërgon njësisë shkresën për përgatitjen e PBA 2023-2025. Informacioni duhet të përcillet brenda datës 1 Korrik 2022 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më datë 13.07.2022 nr. 4692 prot., MAS i dërgon UT shkresën për përgatitjen e PBA 2023-2025 me afat 20.08.2022. Më datë 16.08.2022 nr.1629/9 prot., Universiteti i Tiranës i përcjell MAS PBA brenda afatit.

GMS: Urdhër i Brendshëm nr.25 datë 02.11.2022 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik në Universitetin e Tiranës”. Gjithashtu në këtë vit nuk është organizuar asnjë mbledhje për miratimin e PBA.

- Fakulteti i Shkencave Sociale (shkresa më 07.07.2022, nr.559/6 prot), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 12.07.2022, nr. 907/1 prot.), Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (shkresa më

13.07.2022, nr.486/2 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2023-2025 jashtë afatit 01.07.2022.

- Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë nuk kanë përcjellë informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë shkresore.

Më shkresën 30.09.2022, me Vendimin nr.25, Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2023-2025 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.50 datë 14.10.2022 miratohet nga Bordi i Administrimit.

**- Viti 2023:**

Më datë 14.06.2023, nr.1749 prot., Universiteti i Tiranës i dërgon njërive shkresën për përgatitjen e PBA 2024-2026. Informacioni duhet të përcillet brenda datës 7 Korrik 2023 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më datë 18.07.2023 nr. 4501/1 prot., MAS i dërgon UT shkresën për përgatitjen e PBA 2024-2026 me afat 20.08.2023. Më datë 16.08.2023 nr.1749/9 prot., Universiteti i Tiranës i përcjell MASR programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

GMS: Në mbledhjen e datës 10 Gusht 2023 është diskutuar mbi përgatitjen e materialit për buxhetin afatmesëm 2024-2026 të Universitetit të Tiranës, ku u miratua në parim materiali i PBA.

- Filiali Sarandë (shkresa më 11.07.2023, nr.124/1 prot.), Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (shkresa më 10.07.2023 nr.711/1 prot.), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 19.07.2023, nr.1026/1 prot), Fakulteti i Drejtësisë (shkresa më 01.08.2023, nr. 580/3 prot.), Fakulteti i Shkencave Sociale (shkresa më 09.08.2023, nr. 370/1 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2024-2026 jashtë afatit 07.07.2023.

- Fakulteti i Ekonomisë nuk ka përcjellë informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë zyrtare.

Më datë 23.11.2023, me Vendimin nr.61, Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2024-2026 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.70 datë 19.12.2023 miratohet nga Bordi i Administrimit.

**Konstatim:** Grupi i auditimit pasi mori në administrim dokumentacionin për përgatitjen dhe miratimin e PBA dhe konkludon se miratimi i PBA nga Senati e më pas miratimi përfundimtar nga Bordi i Administrimit në të treja vitet subjekt auditimi është realizuar jashtë afatit të përcaktuar nga MASR. Gjithashtu PBA është dërguar në MAS pa kaluar etapat e miratimit sipas radhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi dhe në fund në MAS. Kjo bie në kundërshtim me ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49 pika c. Shkaku është neglizhenca institucionale dhe efekti që ka është mungesa e efikasitetit në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UT. Rëndësia është e lartë.

**- Hartimi i Buxhetit**

**Për vitin 2021:** Më datë 11.11.2020, UT i përcjell njërive shkresën për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2021. Buxheti i konsoliduar duhet të dërgohet pranë Rektoratit të UT-së brenda datës 15.01.2021. Më pas, me shkresën e datës 14.01.2021, nr.122 prot., ky afat shtyhet deri më 22 Janar 2021. Bordi i Administrimit më 05.01.2021, nxjerr Vendimin nr.1 “Për miratimin e detajimit të grant-it të mësimdhënies nga buxheti i shtetit për vitin 2021”. Më 18.01.2021, nr. 281/1 prot., MASR dërgon shkresën për shpërndarjen e fondeve të shpenzimeve korente, të miratuara për periudhën 2021-2023. Senati Akademik nxjerr Vendimin nr,3 datë 30.03.2021 “Për miratimin paraprak të projekt buxhetit të vitit 2021 për Universitetin e Tiranës”, Bordi i Administrimit nxjerr Vendimin nr.8 datë 06.04.2021 “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2021 për

Universitetin e Tiranës”. Më 12.04.2021, nr. 122/12 prot., Universiteti i Tiranës i përcjell njësjive Buxhetin e Miratuar për vitin 2021.

**Për vitin 2022:** Më datë 03.12.2021 UT i përcjell njësjive shkresën për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2022. Buxheti i konsoliduar duhet të dërgohet pranë Rektoratit të UT-së brenda datës 15.01.2022 në formë shkresore dhe elektronike. Bordi i Administrimit më 05.01.2022, nxjerr Vendimin nr.1 “Për miratimin e detajimit të gran-it të mësimdhënies nga buxheti i shtetit për vitin 2022”. Më 10.01.2022 nr.7403/3 prot., MAS dërgon shkresën me fondet e miratuara në grupin e shpenzimeve korente për vitet 2022-2024. Më 30.03.2022 nr.818.2 prot., UT i dërgon njësjive miratimin e detajimit të Grantit të mbartur për UT-në në vitin 2022. Më 15.03.2022, nr.482/5 prot., MAS përcjell planin e investimeve të miratuara për periudhën 2022-2024. Senati Akademik nënshkruan Vendimi nr.10 datë 05.04.2022 “Për Miratimin Paraprak të Projekt Buxhetit të Vitit 2022 të Universitetit të Tiranës”. Bordi i Administrimit nxjerr Vendimin nr.12 datë 07.04.2022 “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2022 për Universitetin e Tiranës”.

**Për vitin 2023:** Më 24.11.2022 UT i përcjell njësjive shkresën për përgatitjen e buxhetit të konsoliduar për vitin 2022. Buxheti i konsoliduar duhet të dërgohet pranë Rektoratit të UT-së brenda datës 25.01.2023 në formë shkresore dhe elektronike. Bordi i Administrimit më 09.01.2023, nxjerr Vendimin nr.2 “Për miratimin e detajimit të gran-it të mësimdhënies nga buxheti i shtetit për vitin 2023”. Bordi i Administrimit nxjerr Vendimin nr.14 datë 11.04.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të vitit 2023 për Universitetin e Tiranës”.

#### **Zbatimi i Buxhetit**

*Realizimi i Shpenzimeve nga Buxheti kod programi 09450 (në lekë)*

Nr	Emërtimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizimi
1	Paga (600)	1,299,940,772	1,188,062,083	91%	1,222,995,284	1,175,903,215	96%	1,590,618,701	1,554,353,203	98%
2	Sigurimet (601)	213,199,062	196,874,350	92%	203,039,201	199,067,742	98%	254,636,215	207,155,974	81%
3	Shpenzimet operative (602)	246,730,584	203,470,882	82%	296,810,951	250,031,747	84%	284,500,544	216,927,011	76%
4	Bursa (606)	334,290,676	328,867,774	98%	364,072,902	293,336,012	81%	402,026,890	285,436,021	71%
5	Transferta (606)	1,433,925	1,273,125	88%	1,249,220	1,109,207	89%	1,532,497	1,454,025	95%
6	Investime (231)	26,898,460	434,503	1,6%	43,257,520	37,061,400	86%	57,479,714	51,596,061	90%
7	Garanci punimesh (466)	13,197,240	13,197,240	100%	1,199,730	0	0%	1796130	0	0
<b>TOTAL</b>		<b>2,135,690,719</b>	<b>1,932,179,957</b>	<b>90%</b>	<b>2,132,624,808</b>	<b>1,956,509,323</b>	<b>85.9</b>	<b>2,592,590,691</b>	<b>2,316,922,295</b>	<b>89</b>

Burimi: UT

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme rezulton se realizimi për vitin 2021 i buxhetit është në masën 90%, realizimi i buxhetit për vitin 2022 është 85,91% dhe për vitin 2023 89%. Zërat me realizimin më të ulët janë Investimet “231” në vitin 2021 me masën 1,6%, llogaria 602 në vitin 2023 me një realizim prej 76%.

*Realizimi i Shpenzimeve nga Buxheti kod programi 09770 (në lekë)*

Nr.	Emërtimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizimi
1	Shpenzimet operative (602)	21,655,844	1,956,424	9%	41,856,602	9,348,650	22%	48,354,112	48,354,112	39%
2	Bursa (606)							11,560,000	11,420,063	99%
3	Transferta (606)									
4	Investime (231)	41,574,800	0	0	80,480,152	50,908,632	63%	39,121,300	38,959,452	99%
<b>TOTAL</b>		<b>63,230,644</b>	<b>1,956,424</b>	<b>3%</b>	<b>122,336,754</b>	<b>60,257,282</b>	<b>49%</b>	<b>99,035,412</b>	<b>69,040,882</b>	<b>70%</b>
<b>TOTAL BUXHETI</b>		<b>2,198,921,363</b>	<b>1,934,136,381</b>	<b>88%</b>	<b>2,254,961,562</b>	<b>2,016,766,605</b>	<b>89%</b>	<b>2,691,626,103</b>	<b>2,385,963,177</b>	<b>89%</b>

Burimi: UT

Granti buxhetor viti 2021-2023, kod programi 09450. (në lekë)

Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Viti 2021				Viti 2022				Viti 2023			
	Grant fillestar i akorduar per 2021	Grant i trashëguar nga viti 2020	Rialokime/shtesa	Total Grant viti 2021	Grant fillestar i akorduar per 2022	Grant i trashëguar nga viti 2021	Rialokime/shtesa	Total Grant viti 2022	Grant fillestar i akorduar per 2023	Grant i trashëguar nga viti 2022	Rialokime/shtesa	Total Grant viti 2023
Rektorati	283,813,738	34,308,882	(70,536,928)	247,585,692	407,411,782	43,259,701	(14,903,000)	435,768,483	374,151,293	105,894,399	(624,574)	479,421,118
Shkencat Sociale	160,469,099	6,572,455	10,923,857	177,965,411	144,694,443	5,425,113	1,965,000	152,084,556	185,641,198	456,055	19,818,470	205,915,723
Drejtësia	191,927,212	57,826,139	12,277,200	262,030,551	174,099,811	51,638,503	1,416,000	227,154,314	196,672,453	43,402,428	21,619,905	261,694,786
Shkencat e Natyrës	377,582,407	46,545,188	7,550,000	431,677,595	334,746,887	38,396,006	25,676,000	398,818,893	400,572,734	80,133	108,424,143	509,077,010
Gjuhët e Huaja	224,462,219	11,061,466	2,111,439	237,635,124	211,850,766	1,574,652	3,218,000	216,643,418	258,812,321	6,675,855	40,777,086	306,265,262
Histori Filologji-a	204,121,853	20,475,639	16,500,000	241,097,492	184,072,921	10,175,166	2,432,000	196,680,087	203,140,471	41,800	24,901,640	228,083,911
Ekonomisë	362,213,254	44,639,187	21,100,000	427,952,441	371,672,715	10,852,337	4,054,000	386,579,052	406,292,622	5,440,463	40,161,480	451,894,565
Filiat Sarandë	26,661,994	9,025,536	74,432	35,761,962	10,830,015	15,725,327	315,000	26,870,342	22,859,263	4,549,963	1,278,695	28,687,921
ISE	3,388,431	-	-	3,388,431	8,265,311	-	87,000	8,352,311	13,428,969	-	525,901	13,954,870
IFBZ	30,500,000	314	-	30,500,314	38,630,102	-	586,000	39,216,102	43,699,548	2,178,539	2,441,594	48,319,681
Instituti Konfuci UT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>1,865,140,207</b>	<b>230,454,806</b>	<b>-</b>	<b>2,095,595,013</b>	<b>1,886,274,753</b>	<b>177,046,805</b>	<b>24,846,000</b>	<b>2,088,167,558</b>	<b>2,105,270,872</b>	<b>168,719,635</b>	<b>259,324,340</b>	<b>2,533,314,847</b>

Burimi: UT

**Viti 2021:** Granti buxhetor fillestar në vitin 2021 për Universitetin e Tiranës duke përfshirë të gjitha njësitë shpenzuese të tij është 1,865,140,207 lekë. Njësia me grantin me vlerë më të lartë në UT është Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me vlerë 377,582,407 lekë, më pas vjen Fakulteti i Ekonomisë me vlerë 362,213,254 lekë dhe Rektorati me grant që mban vlerën 283,813,738 lekë. Grant të trashëguar nga viti 2020 kanë pasur të gjitha njësitë, përveç ISE dhe Institutit Konfuci. Vlerën më të lartë të grantit të mbartura e mban Fakulteti i Drejtësisë me vlerë 57,826,139 lekë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës me vlerë 46,545,188 lekë dhe Fakulteti i Ekonomisë me vlerë 44,639,187 lekë. Gjatë vitit 2021 ka pasur rialokime/shtesa për të gjitha njësitë shpenzuese përveç ISE, IFBZ dhe Institutit Konfuci.

**Viti 2022:** Granti buxhetor fillestar në vitin 2022 për Universitetin e Tiranës duke përfshirë të gjitha njësitë shpenzuese të tij është 1,886,274,753 lekë. Njësia me grantin me vlerë më të lartë në UT është Rektorati, me vlerë 407,411,782 lekë, më pas vjen Fakulteti i Ekonomisë me vlerë 371,672,715 lekë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës me grant që mban vlerën 334,746,887 lekë. Grant të trashëguar nga viti 2021 kanë pasur të gjitha njësitë, përveç ISE, IFBZ dhe Institutit Konfuci. Vlerën më të lartë të grantit të mbartura e mban Fakulteti i Drejtësisë me vlerë 51,638,503 lekë, Rektorati me vlerë 43,259,701 lekë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës me vlerë 38,396,006 lekë. Gjatë vitit 2022 ka pasur rialokime/shtesa për të gjitha njësitë shpenzuese përveç Institutit Konfuci.

**Viti 2023:** Granti buxhetor fillestar në vitin 2023 për Universitetin e Tiranës duke përfshirë të gjitha njësitë shpenzuese të tij është 2,105,270,872 lekë. Njësia me grantin me vlerë më të lartë në UT është Fakulteti i Ekonomisë, me vlerë 406,292,622 lekë, më pas vjen Fakulteti i Shkencave të Natyrës me vlerë 400,572,734 lekë dhe Rektorati me grant që mban vlerën 374,151,293 lekë. Grant të trashëguar nga viti 2022 kanë pasur të gjitha njësitë, përveç Institutit Konfuci. Vlerën më të lartë të grantit të mbartura e mban Rektorati me vlerë 105,894,399 lekë dhe me një diferencë evidente krahasuar me njësitë e tjera të shpenzimit, Fakulteti i Drejtësisë me vlerë 43,402,428 lekë dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me vlerë 6,675,855 lekë. Gjatë vitit 2023 ka pasur rialokime/shtesa për të gjitha njësitë shpenzuese përveç Institutit Konfuci.

**Konstatim:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit konstatohet se është i pranishëm risku i kryerjes së parashikimeve të pabazuara të cilat reflektohen në përqindje të ulët realizimi. Në vitin 2023 realizimi i llogarisë 602 është 76%, në vitin 2023 llogaria 606 është realizuar në masën 71%, në vitin 2021 llogaria 231 është realizuar në masën 1,6%. Gjithashtu të pranishme janë dhe rialokimet

të cilat evidentohen vit pas viti dhe granti i trashëguar. Nga viti nga viti 2021 kanë pasur grant të trashëguar të gjitha njësitë, përveç ISE, IFBZ dhe Institutit Konfuci. Vlerën më të lartë të grantit të mbartura e mban Fakulteti i Drejtësisë me vlerë 51,638,503 lekë, Rektori me vlerë 43,259,701 lekë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës me vlerë 38,396,006 lekë. Nga vitit 2022 grant të trashëguar kanë pasur të gjitha njësitë, përveç Institutit Konfuci. Vlerën më të lartë të grantit të mbartura e mban Rektori me vlerë 105,894,399 lekë dhe me një diferencë evidente krahasuar me njësitë e tjera të shpenzimit, Fakulteti i Drejtësisë me vlerë 43,402,428 lekë dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me vlerë 6,675,855 lekë. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 3, pika 29. Shkaku është mungesa e një analize të mirëstrukturuar dhe reale për planifikimin e nevojave buxhetore të UT. Efekti që sjell është mungesë efience në arritjen e objektivave të miratuara për UT.

**Konstatim:** Nga auditimi u konstatua se Raportimi dhe monitorimi financiar për vitin 2023 është dërguar me shkresën datë 29.03.2024 nr.9031 prot., duke tejkaluar afatin e Udhëzimit të të MFE nr. 9 datë 20.03.2018, (ku afati është deri në fund të muajit Shkurt) me 30 ditë kalendarike. Kjo bie në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” pika 270. Shkaku është neglizhenca institucionale nga ana e UT dhe efekti që sjell është mungesë efience në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për UT.

#### - Investimet në UT që financohen nga MASR/AKSSHI

*Investime në UT që financohen nga MASR/AKSSHI 2021 (në lekë)*

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit te projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD911	Ngritja e laboratorit të analizave materialeve dhe teknologjisë në arkeologji dhe trashëgimi kulturore	9770	2021	10,996,200	-	
2	18BD915	Ngritja e laboratorit të Spektroskopisë Raman për studimin e mikroplastikës në ekosistemet dentare dhe ujërave të ëmbla	9770	2021	19,500,000	-	
3	18BD925	Pasurimi i laboratorit të kulturave invitro FSHN UT në shërbim të prodhimit masiv e cilësor të kulturave dru-frutore të kërkuara nga fermerët	9770	2021	4,000,000	-	
Total					34,496,200		

Burimi: Universiteti i Tiranës

Llogaria 231 e Universitetit të Tiranës preket vetëm nga projektet me financim të brendshëm, duke qenë se këto të fundit financohen vetëm nga të ardhurat. Përjashtim i këtij rregulli bëjnë vetëm investimet dhe TVSh-të të cilat financohen nga MASR dhe AKKSHI. Në vitin 2021 ishin programuar 3 projekte, në programin 9770 të cilat nuk janë realizuar atë vit.

*Investime në UT që financohen nga MASR/AKSSHI 2022 (në lekë)*

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit te projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD911	Ngritja e Laboratorit të Analizave të Materialeve dhe Teknologjive në Arkeologji dhe trashëgimi Kulturore	9770	2021	10,942,800	10,942,800	100%
2	18BD915	Ngritja e Laboratorit të Spektroskopisë Raman për studimin e mikroplastikave në ekosistemet detare dhe të ujërave të ëmbla	9770	2021	17,640,000	17,640,000	100%
3	18BD925	Pasurimi i Laboratorit të Kulturave in vitro, FSHN, UT në shërbim të prodhimit masiv e cilësor të kulturave dru-frutore të kërkuara nga fermerët	9770	2021	3,468,000	3,377,832	97%

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit të projektit	Plani	Fakti	Realizimi
4	18BD926	Fuqizimi i infrastrukturës laboratorike në biologjinë e ruajtjes, FSHN UT	9770	2022	18,948,000	18,948,000	100%
5	18BD928	Pajisja e laboratorit të Akuakulturës, UT në shërbim të mësimdhënies cilësore dhe përparimit të teknikave të kërkimit në biocenologji	9770	2022	5,161,300	-	0%
6	18BD929	Studimi i mykotoksinave në drithar të prodhuar në Shqipëri. Vlerësimi i rrezikut të kontaminimit dhe ekspozimit të popullatës	9770	2022	3,320,052	-	0%
		Total			59,480,152	50,908,632	

Burimi: Universiteti i Tiranës

*Investime në UT që financohen nga MASR/AKSSHI 2022 (në lekë)*

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit të projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD402	Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesve të rinj dhe studentëve FGJH	9450	2022	23,994,600	23,994,600	100%
2	18BD403	Qendra kërkimore Fintech dhe financa e qëndrueshme FE	9450	2022	4,080,000	4,059,600	100%
3	18BD404	Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit në departamentin e informatikës FSHN	9450	2022	1,505,000	1,395,600	93%
4	18BD405	Modernizimi i kurrikulave dhe mësimdhënies në programet e MP mësuesi në FHF, UT FHF	9450	2022	800,000	706,800	88%
5	18BD406	Rëndësia e inteligjencës artificiale në formimin akademik, FGJH	9450	2022	6,904,800	6,904,800	100%
		Total			37,284,400	37,061,400	

Burimi: Universiteti i Tiranës

Në vitin 2022, nga programi 9770 janë faktuar 3 projektet e nisura në vitin 2021 dhe është proceduar me 3 projekte të reja. Nga projektet e nisura në 2021, 2 prej tyre janë realizuar në masën 100% dhe një prej tyre në masën 97%. Nga projektet e parashikuara për vitin 2022, projekti “Pajisja e laboratorit të Akuakultures, UT në shërbim të mësimdhënies cilësore dhe përparimit të teknikave të kërkimit në biocenologji” dhe projekti “Studimi i mykotoksinave në drithar të prodhuar në Shqipëri. Vlerësimi i rrezikut të kontaminimit dhe ekspozimit të popullatës” nuk janë realizuar ndërsa projekti “Fuqizimi i infrastrukturës laboratorike në biologjinë e ruajtjes, FSHN UT” është realizuar në masën 100%,

Në vitin 2022, nga programi 9450 janë parashikuar 5 projekte të cilat janë realizuar. Tre prej tyre, konkretisht “Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të fuqizimit të kërkuesve të rinj dhe studentëve FGJH”, “Qendra kërkimore Fintech dhe financa e qëndrueshme FE”, “Rëndësia e inteligjencës artificiale në formimin akademik, FGJH” janë realizuar në masën 100%, projekti “Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit në departamentin e informatikës FSHN” në masën 93% dhe projekti “Modernizimi i kurrikulave dhe mësimdhënies në programet e MP mësuesi në FHF, UT FHF” në masën 88%.

Investime në UT që financohen nga MASR/AKSSHI 2023 (në lekë)

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit te projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD421	Ndërkombëtarizimi - Krijimi infrastrukturës didaktike mësimore dhe laboratorike për çeljen e programit studimit bachelor në përkthimin e gjuhës së shenjave shqipe	9450	2023	2,042,785		0%
2	18bd422	Ndërkombëtarizimi Smart lab (sisteme teknologji informacioni)	9450	2023	2,215,226		0%
3	18bd423	Ndërkombëtarizimi përfshirja e praktikave më të mira ndërkombëtare në kurrikulën e programit ekzekutiv mbi anëtarësimin në BE	9450	2023	1,925,000	1,925,000	100%
4	18BD 424	Ndërkombëtarizimi - Përmirësimi dhe rritja e infrastrukturës akademike didaktike dhe kërkimore për realizimin cilësor të programit diplomë e dyfishhtë në shkencat natyrore dhe mjedisore midis Shqipërisë dhe Universiteti Tuscia Itali	9450	2023	1,579,873		0%
5	M110468	Fond i ngrirë-rikonstruksioni i fasadës së FD , veshje me sistem kapot , rikonst. i tarracës dhe ndërtimi i impiantit fotovoltaik. Vlera e plotë e projektit 110.823.998. MAS do të financoje 70% vlerës së plote .pra 77.576.799 lekë dhe Ut do përballojë nga fondet e veta 30% shumes projektit me vlere 33.247.199 lekë	9450	2023	40,000,000	40,000,000	100%
		<b>Totali</b>			<b>47,762,884</b>	<b>41,925,000</b>	

Burimi: Universiteti i Tiranës

Investime në UT që financohen nga MASR/AKSSHI 2023 (në lekë)

Nr.	Kodi i projektit	Emërtimi	Programi	Viti i fillimit te projektit	Plani	Fakti	Realizimi
1	18BD932	Ut lab integruar i mediave digjitale	9770	2023	-	-	
2	18bd939	Ut- krijimi i njësisë laboratorike të kriminalistikës	9770	2023	3,500,000	3,467,520	99%
3	18BD941	UT -Ngritja e infrastrukturës për mbështetjen e krijimit të programit të formimit master për përkthimin e gjuhës së shenjave	9770	2023	20,000,000	19,870,632	99%
4	18BD948	UT- Ndërtimi i infrastrukturës për zhvillimin e kompetencës digjitale dhe mjedisore në edukimin biologjik për mbështetjen cilësore në formimin dhe edukimin e vazhduar të mësuesve	9770	2023	2,000,000	2,000,000	100%
5	18BD929	Blerje pajisje lab. mykotoksina FSHN-AKSSHI	9770	2022	8,460,000	8,460,000	100%
6	18BD928	Blerje pajisje lab. Akuakultures FSHN-AKSSHI	9770	2022	5,161,300	5,161,300	100%
		<b>Total</b>			<b>39,121,300</b>	<b>38,959,452</b>	

Burimi: Universiteti i Tiranës

Në vitin 2023 nga programi 9450 janë programuar të kryhen 5 projekte, 3 prej të cilave nuk u realizuan (“Ndërkombëtarizimi-Krijimi i infrastrukturës didaktike mësimore dhe laboratorike për çeljen e programit studimit bachelor në përkthimin e gjuhës së shenjave shqipe”, “Ndërkombëtarizimi Smart lab (sisteme teknologji informacioni)”, “Ndërkombëtarizimi-Përmirësimi dhe rritja e infrastrukturës akademike didaktike dhe kërkimore për realizimin cilësor të programit diplomë e dyfishhtë në shkencat natyrore dhe mjedisore midis Shqipërisë dhe universiteti Tuscia Itali”). Dy projektet e tjera u realizuan në masën 100%.

Në vitin 2023 nga programi 9770 janë programuar të kryhen 6 projekte, 1 prej të cilëve nuk u realizua (Ut lab integruar i mediave digjitale), ndërsa të tjerët u realizuan në masën 99-100%. Dy prej këtyre projekteve, konkretisht “Blerje pajisje laboratorike mykotoksina FSHN-AKKSHI” dhe “Blerje pajisje laboratorike Akuakultures FSHN-AKKSHI” janë projekte të nisura në vitin 2022.

#### - Të ardhurat

Auditimi mbi planifikimin, realizimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore të Universitetit të Tiranës u krye mbi bazën e të ardhurave të njëjësive të shpenzimit të cilat burojnë nga tarifat e shkollimit dhe regjistrimit të studentëve, tarifa administrimi për vërtetime e konfirmime, dokumentacione, diploma, libreza etj. Të ardhurat përdoren tërësisht nga Universiteti i Tiranës bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 108, pika 3, konkretisht: “Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin pasardhës”. Përgjegjës për përcaktimin e rregullave për shpërndarjen e të ardhurave dhe mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve të financimit është Bordi i Administrimit.

Për periudhën objekt auditimi të ardhurat e realizuara për UT janë:

(në lekë)

Viti	Parashikuar	Realizuar	Diferenca
2021	833,800	798,501	96%
2022	737,801	708,529	96%
2023	693,280	723,565	104%

Burimi i të dhënave: UT

Grupi i auditimit, pasi analizoi tabelën e mësipërme doli në përfundimin se parashikimi i të ardhurave të realizuara për UT përkon me faktin e realizimit.


#### - Realizimi i të ardhurave për Universitetin e Tiranës

(në mijë lekë)

Emërtimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Paga (600)	609,124	397,949	65	539,955	470,276	87	593,216	478,879	81
Sigurimet shoq. dhe shëndetësore (601)	64,026	22,487	35	48,736	27,576	57	71,105	71,105	100
Shpenz.operative (602)	315,332	126,263	40	340,854	131,658	39	311,389	135,971	44
Kuatizacione (605)	5,108	2,434	48	5,998	2,575	43	12,581	1,676	13
Transferta të brendshme (604)				1,590	1,590	100	3,682	3,682	100
Transferta tek individët (606)	3,885	848	22	16,151	16,151	100	8,800	1,724	20
Investime (231)	1,155,129	235,594	20	1,116,243	368,811	33	715,124	112,756	16
Garanci punimesh (466)	33,690	4,623	14	61,622	53,545	87	12,411	5,070	41
Total nga të ardhurat	2,186,296	790,202	36	2,131,153	1,072,186	50	1,728,310	810,867	47

Burimi: UT, përpunuar nga grupi i auditimit

Duke u bazuar në tabelën e mësipërme, grupi i auditimit konkludon se realizimi mesatar vjetor për zërat është në masën 44,3%. Gjithashtu konkludohet se në zërat më problematikë përfshihen dhe llogaria 602, 231. Llogaria 602 në vitin 2021 zë 14,5% të të ardhurave të planifikuara, në vitin 2022 zë 15%, në vitin 2023 zë 18%. Llogaria 231 në vitin 2021 dhe 200 zë 52% të të ardhurave të planifikuara, më vitin 2023 zë 41% të të ardhurave të planifikuara.



Pavarësisht se për llogarinë 602 ka rritje nga viti 2022-2023, përsëri realizimi i tij mbetet problematik. Ndërsa për llogarinë 231 nga viti 2022-2023 kemi ulje me 17%.

Të ardhurat totale

Viti	Të ardhurat neto/reale në total sipas viteve	Të ardhura të trashëguara në vitin pasardhës	Diferenca
2021	3,436,112,620	1,331,731,254	38%
2022	2,040,260,690	1,021,619,542	50%
2023	1,745,184,147	939,386,101	53%

Burimi: UT

**Konstatim:** Pas auditimit të Realizimit të fondeve nga të ardhurat dytësore (kap. 6) grupi i auditimit konkludon se ka një realizim mesatar për zërat në masën 44,3%, ku zërat me realizimin më të ulët janë artikulli 602 “Shpenzime Operative” në vitin 2021 realizim 40%, në vitin 2022 realizim 39%, në vitin 2023 ka realizim prej 44%. Artikulli 231 “Investime” me realizim me realizim 20% në vitin 2021, 33% në vitin 2022 dhe 16% në vitin 2023. Gjithashtu duke u bazuar në të ardhurat e trashëguara të cilat në vitin 2021 janë 38% e vlerës së të ardhurave, në vitin 2022 janë 50% e të ardhurave dhe vitin 2023 janë 53% e të ardhurave. Këto konkluzione vërtetojnë mosvënien në përdorim të të ardhurave të realizuara nga UT dhe mungesën e një analize të saktë dhe efektive ekonomike mbi shfrytëzimin e fondeve për nevojat e institucionit. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar,, konkretisht: neni 3, pika 29, neni 4 pika b dhe ç, neni 5. Shkaku është mungesa e një analize të mirëstrukturuar mbi planifikimin dhe shpenzimin e të ardhurave dhe efekti është ngadalësimi i arritjes së qëllimeve të UT dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve të cilat do të ndikojnë në realizimin e misionit të institucionit.

Të ardhurat sipas njësive të shpenzimit (në lekë)

Njësia	2021	2022	2023
Rektorat	74,946,325	19,380,282	14,508,626
Fakulteti i Shkencave Sociale 11	97,563,495	88,897,516	86,668,334
Fakulteti i Drejtësisë 11	126,802,731	117,230,519	115,249,681
Fakulteti i Shkencave të Natyrës 13	102,488,375	100,843,886	89,297,000
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja 19	93,721,765	78,736,134	74,945,474
Fakulteti Histori-Filologji 15	98,063,879	96,083,360	83,438,437
Fakulteti i Ekonomisë	159,157,951	157,640,107	208,881,500
Filiali Sarandë	4,082,988	4,105,821	5,284,000
ISE	5,700,873	3,197,299	7,390,000
IFBZ	23,612,099	24,057,845	21,937,538
Instituti Konfuci UT	12,360,140	18,356,667	15,964,015

Burimi: UT, përpunuar nga Grupi i Auditimit

Nga tabela e mësipërme vihet re se në vitin 2021 për Universitetin e Tiranës, të ardhurat më të mëdha janë grumbulluar nga Fakulteti i Ekonomisë në vlerën 159,157,951 lekë, Fakulteti i Drejtësisë në vlerën 126,802,731 lekë dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës në vlerën 102,488,375

lekë. E njëjta renditje dhe për vitin 2022 ku FEUT grumbulloi 157,640,107 lekë, Fakulteti i Drejtësisë 117,230,519 lekë dhe FSHN 100,843,886 lekë. Edhe për vitin 2023 të ardhurat më të mëdha i grumbulloi FEUT me 208,881,500 lekë, FDUT me vlerë 115,249,681 lekë dhe FSHN 89,297,000 lekë. Gjithashtu në të treja vitet, vihet re një tendencë uljeje e të ardhurave për Fakultetet. Ky mund të jetë indikacion i uljes së numrit të studentëve, që sjell ulje të numrit të tarifave të paguara, të certifikatave, vërtetimeve e diplomave të tërhequra në vit në Fakultete. Uljet më të mëdha vihen re në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja me një diferencë prej 18,776,291 lekë nga viti 2021 në vitin 2023, në Fakultetin Histori-Filologji me një diferencë prej 14,625,442 lekë nga viti 2021 në vitin 2023 dhe në Fakultetin e Shkencave të Natyrës me diferencë 13,191,375 lekë, Përrjashtim bën Fakulteti i Ekonomisë, në të cilin vihet re rritje në vlerën 51,241,393 lekë nga viti 2022 në vitin 2023.

#### **- Kërkimi Shkencor:**

Veprimtaria Kërkimore-Shkencore synon të mbështesë zhvillimin e vendit dhe rritjen e cilësisë së arsimit dhe si e tillë është një nga hallkat kryesore të arsimit të lartë.

*Kërkimi shkencor 2021-2023 (në mijë lekë)*

Viti	Të ardhura			Buxhet			Total		
	Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizimi	Plan	Fakt	Realizim
2021	122,679	49,016	39%	40,639	18,348	45%	163,318	67,364	41%
2022	147,206	43,437	29%	23,106	17,356	75%	170,312	60,793	35%
2023	153,293	46,713	30%	29,818	28,452	95%	183,111	75,165	41%

*Burimi: UT, përpunuar nga grupi i auditimit*

Zëri 602 nga të ardhurat: viti 2021 realizim gjithsej 126,263 mijë lekë, prej të cilave 38% për kërkimin shkencor dhe 62% për shpenzime operative

Viti 2022: realizim gjithsej 131,658 mijë lekë, prej të cilave 32% për kërkimin shkencor dhe 68% për shpenzime operative

Viti 2023: realizim gjithsej 135,971 mijë lekë, prej të cilave 34% për kërkimin shkencor dhe 66% për shpenzime operative

Zëri 602 nga buxheti: viti 2021 realizim gjithsej 203,470,882 lekë, prej të cilave 9% për kërkimin shkencor dhe 91% për shpenzime operative

Viti 2022: realizim gjithsej 250,031,747 lekë, prej të cilave 6% për kërkimin shkencor dhe 94% për shpenzime operative

Viti 2023: realizim gjithsej 216,927,011 lekë, prej të cilave 13% për kërkimin shkencor dhe 87% për shpenzime operative.

Sipas tabelës së mësipërme mund të konkludohet se përqindja e realizimit për të treja vitet ka një mesatare prej 39%, Problematikat më të mëdha gjenden në kërkimin shkencor të financuar nga të ardhurat, ku për vitin 2021 ka një realizim prej 39%, në vitin 2022 29% dhe në vitin 2023 30%. Ky është një tregues për një parashikim jo të saktë të të ardhurave, shpenzim jo eficient të tyre. Në vitin 2021 për Kërkimin Shkencor të financuar nga Buxheti ka një realizim prej 45%, që bie në kundërshtim me Ligjin nr.57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 4.

**Konstatim:** Grupi i auditimit pasi kreu një analizë të të dhënave mbi rezultatet e Kërkimit Shkencor, konstaton se përqindja e realizimit për të treja vitet ka një mesatare prej 39%, Problematikat më të mëdha gjenden në kërkimin shkencor të financuar nga të ardhurat, ku për vitin 2021 ka një realizim prej 39%, në vitin 2022 29% dhe në vitin 2023 30%. Gjithashtu vihet re se nga të ardhurat, për vitin 2021 38% e llogarisë 602 është parashikuar për këtë mision, në vitin 2022 32% e llogarisë 602 për kërkimin shkencor. Ndërsa nga granti 9% është parashikuar për kërkimin shkencor në vitin 2021 dhe 6% në vitin 2022. Kjo bie në kundërshtim me Ligjin nr.57 datë

02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 4, Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 1 pika a. Shkaku është mungesë vëmendjeje institucionale dhe efekti që kjo dukuri ka është mungesa e efikasitetit në arritjen e një prej misionëve të arsimit të lartë. .

## **2.2. AUDITIM I LLOGARIVE VJETORE.**

### **2.2.1 Auditim i Llogarive Vjetore të Konsoliduara të Universitetit të Tiranës për vitin 2022.**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Pasqyrat financiare të konsoliduar viti 2022 të shoqëruar me formatet 1-9;*
- *Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues;*
- *Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve, libri i aktiveve;*
- *Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor;*
- *Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat, etj.).*

Pasqyrave financiare, janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 618/12 prot. datë 28.04.2023 sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës. Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formatit nr.1; Pasqyrën e performancës financiare sipas formatit nr.2; Pasqyrën e flukseve monetare sipas formatit nr.3; Pasqyrën e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto sipas formatit nr.4; Pyetësorin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.5 dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën e Investimeve dhe Burimet e financimit sipas formatit nr.6, Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivet e Afatgjata (Kosto Historike) sipas formatit nr.7/a Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlerë Neto) sipas formatit 7/b; si dhe Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.8. Bashkangjitur gjendet dhe relacioni shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

UT Tiranë operon me thesarin dhe për projektet me financime të huaja me bankën e nivelit të dytë. Objekt i auditimit janë pasqyrat financiare të njëjësive shpenzuese dhe të konsoliduar, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, fluksit të parave, pasqyrat statistikore të investimeve, gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (kosto historike/ neto) si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare.

Auditimi është fokusuar vetëm në aspektet që kanë të bëjnë me auditimin financiar, duke kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të koordinimit të të dhënave origjinale, nëpërmjet kontrollit të dokumenteve të mbajtura nga administratorët; krahasimin e besueshmërisë së të dhënave të kontabilitetit dhe analizimin kritik të tyre me aftësinë e tyre për të dhënë informacion, nëpërmjet rishikimit sistematik të kontabilitetit dhe pasqyrave financiare; krahasimin e të dhënave të bilancit, shqyrtimin kritik të tij dhe krahasimin me parametra ligjor të përcaktuar. Regjistrimet kontabël janë të bazuara në dokumentacionin bazë, i cili është i autorizuar dhe i aprovuar nga personat e ngarkuar, me autoritetin që kanë në përputhje me rregullin e brendshëm. Çdo fakultet përgatit pasqyrat përkatëse të cilat konsolidohen nga Rektori. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e koston historike. Aktivet monetare përfaqësojnë paratë në bankë dhe në arkë, të cilat janë

vlerësuar dhe mbahen me vlerën e drejtë. Regjistrimet e transaksioneve në monedhë të huaj, janë regjistruar në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore institucioni është mbështetur në Udhëzimet e MFE nr.8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 si dhe udhëzimin përkatës vjetor.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA S.Z me detyrë Administrator i UT Tiranë dhe NZ L. P me detyrë Drejtor Ekonomik, dhe janë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 618/12 prot. datë 28.04.2023, në përputhje me afatet e përcaktuar në pikën 120 të UMF nr.8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

- *Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:*

Nga ana e UT Tiranë si dhe njësitë shpenzuese në varësi të saj, janë kryer rakordimet periodike me Thesarin si dhe raportimet periodike me institucionet e varësisë (MAS, MFE, etj.).

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- *mbështetjen në dokumente justifikuese dhe vërtetuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);*

- *mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;*

- *tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.*

*Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:*

- *shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;*

- *kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese dhe vërtetuese mbi të cilat është përgatitur;*

- *verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.*

- *Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit :*

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

Në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale në program “Excel”. UT Tiranë, në sistemin kontabël që përdor për përcaktimin, marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare të veprimtarive të njëjësive ekonomike nuk përdor bartësit informatikë, duke shfaqur rritje të riskut të gabimeve si dhe të vështirësive për monitorim të sistemit, mungesën e të dhënave financiare në kohë reale për t’u reflektuar në vendim-marrjen e organeve drejtuese të shoqërisë. Ky fakt ndikon në mos kontroll për sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave për të gjitha veprimet dhe ngjarjet ekonomike, mundësi për ndryshim të tyre nga përdoruesit dhe rezulton mos vlerësim sa dhe si duhet i programeve informatike bashkëkohore.

**Konkluzion:** Azhornimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët shpenzimeve të thesarit, bankës, të të ardhurave, magazinës, të pagave, ditari i veprimeve të ndryshme, etj.. Gjithashtu të hedhura këto në librin e madh/ centralizator.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë vërtetues e justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentet vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, në përgjithësi janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet, etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

**- Auditim i Pasqyrave Financiare të Konsoliduar për vitin 2022.**

Auditimi i aktiveve të qëndrueshme, (pasqyrat financiare /bilanci i vitit 2022):

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë deviacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara dhe evidentimi kontabël i tyre.

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 4,159,301,242 lekë.

Aktivet 4,330,352,804 lekë

Pasivet 171,051,562 lekë

Aktivet neto 4,159,301,242 lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 1,692,857,041 lekë dhe përbëhen nga:

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 1,326,663,784 lekë,

**Llogaritë e Klasës 3** “Gjendje inventari qarkullues”, në shumën 204,591,544 lekë.

**Llogaritë e Klasës 4** “Llogari të arkëtueshme”, në shumën 161,601,713 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë			
56	Mjete monetare ne bankë	94,366,994	20,204,966	74,162,966
520	Disponibilitete në thesar	1,232,296,790	1,557,542,810	(325,246,020)
Totali		1,326,663,784	1,577,747,776	(251,083,054)

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në vlerën 1,326,663,784 lekë përbëhet nga Vlera e llogarisë 56 “Mjete monetare në bankë” në shumën 94,366,994 lekë dhe 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,232,296,790 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin, përbëhet nga të ardhurat e trashëguara në vlerën 1,021,619,351 lekë për kapitullin 06 dhe 201,227,590 lekë për kapitullin 08 mbledhur me gjendjen e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje” në shumën 9,449,849 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likujditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”.

**Llogaritë e klasës 5**, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**Llogaritë e Klasës 3** “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	147,757,029	130,025,443	17,731,586
32	Inventar i imët	56,834,515	31,492,810	25,341,705
	Totali	204,591,544	161,518,253	43,073,291

**Llogaritë e Klasës 3**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 204,591,544 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 147,757,029 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 56,834,515 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 43,073,291 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 43,073,291 lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 147,757,029 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhëset dhe aktrakordimin e mbajtur në fund të vitit me komisionet dhe përgjegjësit material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	130,025,443
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	170,582,950
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	152,851,364
Gjendja në 31.12.2022	147,757,029

**Llogaria 32 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 56,834,515 lekë vlerë e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhëset dhe aktrakordimet e mbajtura në fund të vitit me komisionet dhe përgjegjësit material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	31,492,810
Hyrje gjatë vitit 2022	26,768,937
Dalje gjatë vitit 2022	1,427,232
Gjendja në 31.12.2022	56,834,515

**Llogaritë e klasës 3** kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e Klasës 4** “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme	161,601,713	133,788,777	27,812,936
411	Klientë e llogari te ngjashme	2,157,274	3,455,200	(1,297,926)
468	Debitorë te ndryshëm	4,321,625	4,321,625	0
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	155,122,814	126,011,952	29,110,862
	Totali	161,601,713	133,788,777	27,812,936

**Llogaria 411** “Klientë llogari të ngjashme”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 2,157,274 lekë, e cila përfaqëson të ardhurat e paarkëtuara për mallra dhe shërbime, e krahasuar me vitin 2021 është ulur në vlerën 1,297,926 lekë.

**Llogaria 468** “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 4,321,625 lekë paraqitet e pandryshuar nga viti i kaluar për arsye se UT është në proces gjyqësor me Debitorët dhe nuk është marrë ende vendimi.

Llogaria e analizuar paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr.	Debitorët	Shuma	Viti i krijimi	Mundësi arkëtimi
1	Xh. F. detyrim nga KLSH	163,800	2010	Proces gjyqësor
2	Punonjësit e UT – së sipas listës, detyrim nga KLSH	39,167	2010	Proces gjyqësor
3	4.	826,662	2013	Po
4	J. ShPK	10,860	2013	Proces gjyqësor
5	N.	186,959	2013	Proces gjyqësor
6	N.	3,006,438	2013	Proces gjyqësor
7	S. B.	87,739	2018	Lap Top
		4,321,625		

Problematikë lidhur me gjendjen e debitorëve të paraqitur në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” Nga auditimi rezultoi se nga Universiteti i Tiranës, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e debitorëve të krijuar nga vitet 2010-2018 , në vlerën 4,321,625 lekë. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke i kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”, ku citohet: .....Garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhjet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta.

Mangësitë e mësipërme sjellin për pasojë kalimin i afatit të parashkrimit të detyrimeve të arkëtueshme për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor për mbledhjen e detyrimeve.

**Llogaria 4342** “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 155,122,814 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore dhe furnitorë për mallra e shërbime dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 155,122,814 lekë.

**- Aktivët Afatgjata jomateriale (AAJM).**

**Llogaritë e Klasës 20** “Aktivët Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën prej 78,888,407 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 74,718,214 lekë, ndryshimi nga viti i kaluar korrespondon me amortizimin e llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 115,805,275 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 115,805,275 lekë. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime "

Nr.	Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Gjendje 01.01.2022	Gjendje 31.12.2022	Sipas bilancit	Komente
1	Rektorati "Studim projektim "Kampusi I UT"	99,720,000	99,720,000	99,720,000	Ky projekt gjendet pranë sektorit të investimeve, DP-UT .Projekti nuk është zbatuar problematike çështje pronësie .
2	Shkencat Sociale	4,317,160	4,317,160	4,317,160	
3	Shkencat e Natyrës, "Përgatitja dhe Aktivizimi i nanomaterialeve të tipit ilmenit si dhe vlerësimi i efikasitetit të tyre për pastrimin e tokave të ndotura nga metalet e rënda"	255,530	255,530	255,530	Majlinda Vasjari, Projekt I Mbyllur
6	Histori Filologji-a	11,512,585	11,512,585	11,512,585	
Totali		115,805,275	115,805,275	115,805,275	

**- Aktivët e afatgjata materiale (AAM).**

**Llog 211** “Pyje, Plantacione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 433,101 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 411,447 lekë, pakësimi prej 21,654 korrespondon me amortizimin vjetor të llogaritur në masën 5%.

Ndërsa sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 455,896 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”	Çelja 01.01.2022	Shtesa gjatë vitit 2022	Paksime gjatë vitit 2022	Gjendja me 31.12.2022
vlera e pemëve dhe bimëve të mbjella në Kopshtin Botanik, si Qendër Kërkimore Shkencore, FSHN	455.896			455.896
	455,896	0	0	455,896

**Llog 212** “Ndërtesa konstruksione” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,599,734 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 2,246,659,198 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 2,233,192,249 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 13,466,949 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

1- Blerje e krijuar me pagesë sipas kontratës nr.2212/11, dt 17.10.22, shuma likuiduar 3,349,.166 lekë, e cila do t’i kalohet FSHN me çlirimin e 5% të garancisë

2- Shtesa dhe pakësime (sistemime) brenda sistemit

Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto dhe sipas fakulteteve në tabelave të mëposhtme:

NR	Përshkrimi	Gjendje	Shtesa me pagese	Shtesa/ pakësimi (sistemime) Brenda sisitemit	Gjendje ne fund
1	Rektorati	10,958,742			10,958,742
1	Godina Liria-Kinoklubi	129,996,160			129,996,160
1	Rehabilitim I kopshtit Botanik kontr nr.2212/11, dt 17.10.22		3,349,166		3,349,166
2	Shkencat Sociale	192,743,631			192,743,631
3	Drejtësisë	215,854,250		(11,295,507)	204,558,743
4	Shkencat e Natyrës	614,635,945			614,635,945
5	Historisë	156,081,852			156,081,852
6	Gjuhët e Huaja	105,433,969		2,820,351	108,254,320
7	Ekonomisë	743,904,743		18,592,939	762,497,682
8	FSR	180,000			180,000
9	IFBZ	62,224,005			62,224,005
10	ISE	1,178,952			1,178,952
		2,233,192,250	3,349,166	10,117,783	2,246,659,199

NR	Fakulteti:	Përshkrimi	Shuma
1	Rektorati	Rektorati	10,958,742
2	Rektorati	Godina Liria-Kinoklubi	129,996,160
3	Rektorati	Rehabilitim I kopshtit Botanik	3,349,166
4	Fakulteti i Shkencave te Natyrës	Godina A	150,563,226
5	Fakulteti i Shkencave te Natyrës	Godina B	76,291,171
6	Fakulteti i Shkencave te Natyrës	Godina C	94,784,682
7	Fakulteti i Shkencave te Natyrës	Godina D	165,443,277
8	Fakulteti i Shkencave te Natyrës	Muzeu i Shkencave te Natyrës	127,553,589
9	Fakulteti i Shkencave Sociale	ish NPV ushtarake	192,743,631
10	IFBZ	IFBZ( A,B,C,D,E)	62,224,005
11	Historisë	Godina e Fakultetit Historisë	156,081,852
12	Gjuhët e Huaja	Godina e Fakultetit Gjuhëve te Huaja	108,254,320
13	Ekonomisë	Godina A+B	762,497,682
14	FSR	Dere e blinduar	180,000
15	ISE	ISE	1,178,952
16	Drejtësisë	Drejtësisë	204,558,743
<b>Totali</b>			<b>2,246,659,198</b>

Zbatim i pjesshëm i VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se UT administron pronat e tij në përputhje me VKM nr. 430, datë 02.07.2014, i ndryshuar, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore”. Me shkresën nr. 02/1 prot. datë 23.01.2024, Administratori i UT ka informuar Ministrinë e Arsimit se, në zbatim të VKM – së nr. 430, datë 02.07.2014, nga ana e institucionit është vijuar me procedurat për regjistrimin e pasurive në përputhje me listën e inventarit të pronave të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi UT – së. Nga auditimi rezultoi se UT disponon çertifikata pronësie vetëm për 5 nga 21 pasuritë e kaluara në administrim dhe për pjesën tjetër është në proces regjistrimi

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar pika 2 dhe 9.

Situata e cituar më sipër sjell për pasojë mangësi në formalizimin e marrëdhënies së institucionit me asetet e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” për shkak të mungesës së disponimit të titujve të pronësisë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 197/50 prot., datë 06.09.2024 “Observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit protokolluar në KLSH me shkresën nr. 103/22 prot., datë 09.09.2024, ku janë shprehur se:

**Pretendimi i subjektit:**

*Universiteti i Tiranës është dakord me rekomandimin e lënë nga KLSH-ja, strukturat e UT-së do të marrë masat, për mbylljen e procedurave dhe pajisjen me certifikatë pronësie për godinat e regjistruara në llogarinë 212 “ Ndërtesa dhe Konstruksione”.*

**Komenti i grupit të auditimit:**

Observacioni i mësipërm pranohet.

**- Mbi vlerën kontabël të aseteve të regjistruara në Aktivet e Universitetit të Tiranës.**

Nga auditimi rezultoi se, periudha e hyrjes dhe regjistrimit të aseteve në aktivet e Universitetit të Tiranës është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të aseteve me qëllim për afrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin sikurse parashikohet në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”, duke sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Financiare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit” dhe UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.

Mangësitë e mësipërme sjellin për pasojë pasqyrim jo të saktë të vlerës reale të aktiveve të institucionit për shkak të mos kryerjes së procesit të rivlerësimit të aktiveve.

**Llog 214** “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 438,463,361 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 1,210,067,812 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 966,324,130 lekë.

Kemi rritje në vlerën 340,564,848 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë, në vlerën 179,034,504 lekë, nga rritja e AAGJM analizuar më poshtë:

Kontrate:	Vlera kontratës	Vlera likuiduar
kont nr.2231/113, dt 10.11.2022 "Shpznz digjitalizim arkive FGJH"	18,162,000	17,991,576
kontr nr. 2439/7, dt 21.11.2022" Blerje pajisje Lab FGJH "/AKKSHI	23,994,600	23,994,600
Kontr nr.1933/28, dt 9.3.2022 "FV rrjet interneti dhe servera për FSHN"	14,338,968	14,338,968
kontr nr.2513/10, dt 2.2.2022" blerje paj.elektronike"	47,164,896	47,164,896
Kontr nr.6248, dt 28.09.2021 "upgrade sistemi baze se te dhenave RDBMS"	49,800,000	49,800,000
urdher nr.3096/9, dt 29.12.2022	120,554	120,554
kontrate nr.2235/15, dt 20.12.2022 Pajisje Elektoronike	67,680,000	14,304,008
IFBZ TVSH		4,228,824

Kontrate:	Vlera kontratës	Vlera likuiduar
Projekte UT		7,091,078
Totali	221,261,018	179,034,504

Sipas njëjësive shpenzuese për llogarinë 214, shtesat dhe pakësimet paraqiten si më poshtë vijon:

Nr.	Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Gjendje 01.01.2022	Shtesa me pagese	Shtesa pa pagese jashte sistemi	Shtesa pa pagese pagese	Pakesime/nxjerrje jashte perdorimi	Pakesime	Gjendje 31.12.2022
1	Rektorati	129,856,005	167,714,602				80,132,954	217,437,653
2	Shkencat Sociale							-
3	Drejtësia	32,774,964			28,294,037			61,069,001
4	Shkencat e Natyrës	418,165,366			95,024,397	13,164,378		500,025,385
5	Gjuhët e Huaja	8,545,832			80,000			8,625,832
6	Histori Filologji-a	5,983,022						5,983,022
7	Ekonomisë	61,716,928						61,716,928
8	Filiali Sarandë	2,798,617		525,003	270,720			3,594,340
9	ISE	1,627,743			281,880			1,909,623
10	IFBZ	299,228,172	4,228,824	18,855,767	17,640,000			339,952,763
11	konfuci	5,627,481	558,540					6,186,021
12	Projektet LL.Speciale		7,091,078				3,523,834	3,567,244
	<b>Totali</b>	<b>966,324,130</b>	<b>179,593,044</b>	<b>19,380,770</b>	<b>141,591,034</b>	<b>13,164,378</b>	<b>83,656,788</b>	<b>1,210,067,812</b>

Pakesime në vlerën 96,821,166 lekë”, janë daljet që bëhen nga Rektorati si njësi qendrore për të gjitha blerjet që bëhen për fakultetet. Nxjerrjet jashtë përdorimit nga informacioni i marrë nga Fakultetet janë kryer procedurat në zbatim të Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”.** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Universitetit më datë 31.12.2022 në shumën 2,759,990 lekë, (në vlerë neto). Pakësimi në vlerën 689,997 lekë korrespondon me amortizimin e llogaritur në masën 25%.

Ndërsa sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 25,120,200 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 25,120,200 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në

Njësia Shpenzuese	Emërtimi i objektit	Viti blerjes	Gjendja Kontabël		Vlera Historike	Amortizimi akumuluar 01.01.2022	Amortizimi vjetor	Amortizimi akumuluar 31.12.2022	Vlera Neto
			sasia	çmimi					
Rektorati	Minibus KIA (TR3439K) vit prodh 2003	2004	1	1,990,000	1,990,000	1,737,068	50,586	1,787,654	202,346
Rektorati	MINIBUS VË TRANSPORT TR 7863 M vit prodhimi 2006	2006	1	3,470,000	3,470,000	3,011,307	91,739	3,103,046	366,954
Rektorati	Makine tip hundai tr4085 u	2007	1	2,991,981	2,991,981	2,481,372	102,122	2,583,494	408,487
Rektorati	IVECO fiat Turbo daily Tr 7894 A vit prodh	1992	1	2,140,000	2,140,000	2,099,941	8,012	2,107,952	32,048
Rektorati	NISAN PATROL Tr 9925E vit prodh 1995	2001	1	1,600,000	1,600,000	1,469,292	26,142	1,495,433	104,567
Konfuci	Ford mondeo AA923 UG, vit prodh 2017	2018	1	3,558,799	3,558,799	1,501,814	411,397	1,913,211	1,645,588
IFBZ	Mitsubishi AA895AN Viti I prodhimit 2009,	2009	1	3,540,479	3,540,479	3,540,479		3,540,479	-
IFBZ	Volksägen AA0470E, Viti I prodhimit 2016,	2017	1	3,219,794	3,219,794	3,219,794		3,219,794	-
FSHS	Makine , tipi Mercedes Benz 300, targa TR 7996	2000	1	1,000,000	1,000,000	1,000,000	-	1,000,000	-
FSHS	Makine, Tipi Mercedes Benz , targa TR 8988H vit prodhimi 1992	2003	1	1,609,146	1,609,146	1,609,146	-	1,609,146	-

Njësia Shpenzuese	Emërtimi i objektit	Viti blerjes	Gjendja Kontabël		Vlera Historike	Amortizimi akumuluar 01.01.2022	Amortizimi vjetor	Amortizimi akumuluar 31.12.2022	Vlera Neto
			sasia	çmimi					
	<b>Totali</b>				<b>12,191,981</b>	<b>10,798,979</b>	<b>278,600</b>	<b>11,077,580</b>	<b>1,114,401</b>

**Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga universiteti. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 398,120,732 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 521,408,417 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,073,146,833 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 1,264,681,660 lekë. Kemi rritje në vlerën 502,941,458 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

1- Blerje me pagesë në vlerën 298,103,766 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Kontrate	Vlere	Likuiduar
kont nr.2515/11, dt 1.12.21 bl paj.operacionale (kond, chiller, sis.asp)	9,021,132	9,021,132
kontrate nr.2791/39, dt 24.01.22 "Dep fizikes"	7,425,120	7,425,120
kontr nr.2791/47, dt 24.01.22"paj. Laboratorike ifbz"	2,580,000	2,463,900
Kont NR. 4217/8, DT 14.2.2022"paj. Laboratorike Muzeun e FSHN"	3,532,920	3,532,919
Kontr nr. 2206/7 date 21.11.2022 pajisje Lab FSHN	18,948,000	18,948,000
kontr nr.2971/8, dt 22.12.2021 "Blerje pajisje lab. Arkeologjise kulturore"	10,942,800	10,942,800
kontrate nr. 2791/69, dt 03.02.2022 Blerje pajisje lab. Për dep.biologjise dhe Blerje pajisje lab. Për dep.bioteknologjise	19,616,280	19,616,280
kontrate nr. 2791/32, dt 30.12.2021 "blerje pajisje lab. Për dep.e kimise"	11,991,600	11,991,600
Kont NR. 4217/8, DT 14.2.2022 blerje fond libri	11,546,105	11,546,105
kontr nr.2235/9, dt 18.11.2022 "blerje pajisje audiovizuale për UT"	26,381,520	26,381,520
kont nr.759/12, dt 9.9.22 blerje pajisje elektronike proj AUF-covid "	887,090	887,090
kontr nr. 3077/7, dt 18.1.22 blerje pajisje për lab didaktik FGJH	23,845,320	23,845,320
kontr nr.2514/7, dt 1.12.2021, blerje pajisje për lab perkthimi FGJH	17,472,000	17,472,000
kontrate nr.2235/15, dt 20.12.2022," blerje pajisje-audiovizuale"	14,730,120	14,730,120
kontr nr.2512/19, dt 24.01.2022	42,000,204	42,000,204
Kontr nr. 2526/7, dt 25.11.2022 "FV pajisje elektronike për projektet e nderkombetarizimit për vitin akademik 2022-2023"	13,066,800	13,066,800
kontr nr.4005/7, dt 30.12.2021 Shpznz paj lab kulturave invitro FSHN	3,468,000	3,365,278
kontr nr. 4006/7, dt 23.12.2021 "lab Raman mikroplastikes"	17,640,000	17,640,000
kontr nr.2971/8, dt 22.12.2021 blerje pajisje lab. Për dep.e kimise industriale"	15,148,800	15,148,800
kontr nr.1805/10, dt 19.9.22 rik rrjeti jashtem elektrik IFBZ site pjesor nr. 1	1,305,073	1,304,921
kontr 2433/7, dt 01.12.2022 "Shpz rip Tarrace FHF Sit nr. 1."	5,673,963	4,825,800
kontr nr.2233/9, dt 12.12.2022" Blerje pajisje mobilimi"	45,651,420	19,417,800
Urdher nr. 2094/14 date 29.12.2022	594,540	594,540
Konfuci	1,001,276	1,001,276
IFBZ	934,441	934,441
	<b>325,404,524</b>	<b>298,103,766</b>

2- Shtesa pa pagesë në vlerën 204,837,692 lekë të krijuara brenda dhe jashtë sistemit.

3-Pakësime në vlerën 311,406,631 lekë janë daljet që bëhen nga Rektorati si njësi qendrore për të gjitha blerjet që bëhen për fakultetet. Nxjerrjet jashtë përdorimit nga informacioni i marrë nga Fakultetet janë kryer procedurat në zbatim të Udhëzimit Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Sipas njërive shpenzuese për llogarinë 218, shtesat dhe pakësimet paraqiten si më poshtë vijon:

Nr.	Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Gjendje 01.01.2022	Shtesa me pagese	Shtesa pa pagese jashtë sistemi	Shtesa pa pagese	Pakesime/nxjerrje jashtë përdorimi	Pakesime	Gjendje 31.12.2022
1	Rektorati	72,487,411	296,168,050				292,742,654	75,912,807
2	Shkencat Sociale	155,413,751		244,193	1,839,237			157,497,181
3	Drejtesia	93,293,822			6,655,750			99,949,572

Nr.	Njësitë shpenzuese (Fakultete, etj.)	Gjendje 01.01.2022	Shtesa me pagese	Shtesa pa pagese jashtë sistemi	Shtesa pa pagese	Pakesime/nxjerrje jashtë përdorimi	Pakesime	Gjendje 31.12.2022
4	Shkencat e Natyrës	210,111,673			17,621,604	8,687,111		219,046,166
5	Gjuhët e Huaja	108,602,746			146,814,146	9,857,513		245,559,379
6	Histori Filologji-a	193,976,094		22,815,326	(13,292,810)			203,498,610
7	Ekonomisë	193,735,748			21,895,446			215,631,194
8	Filiali Sarandë	13,258,170			244,800		119,353	13,383,617
9	ISE	4,069,080						4,069,080
10	IFBZ	24,605,192	934,440					25,539,632
11	konfuci	3,593,146	1,001,276					4,594,422
12	Projektet LL.Speciale							-
	<b>Totali</b>	<b>1,073,146,833</b>	<b>298,103,766</b>	<b>23,059,519</b>	<b>181,778,173</b>	<b>18,544,624</b>	<b>292,862,007</b>	<b>1,264,681,660</b>

**Llogaria 219** “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Universitetit në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (2,225,294,279) lekë. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (283,785,576) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

- 1- 202 Amortizim i studimeve e kërkimeve në vlerën 4,170,193 lekë
- 2- 211 Pyje kullota Plantacione në vlerën 21,654 lekë.
- 3- 212 Ndërtime e konstruksione në vlerën 83,509,791 lekë
- 4- 214 Instalime teknike,pajisje,vegla pune në vlerën 115,373,369 lekë
- 5- 215 Mjete transporti në vlerën 689,997 lekë
- 6- 218 Inventari ekonomik në vlerën 80,020,572 lekë.

#### - PASIVET (DETYRIMET)

##### Pasivet Afatshkurtra.

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e UT më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
	1. Llogari te Pagueshme	171,051,562	162,854,114	8,197,448
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	14,503,164	2,140,080	12,363,084
42	Detyrime ndaj personelit	91,062,009	79,582,893	11,479,116
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	13,625,696	13,010,785	614,911
435	Sigurime Shoqërore	31,697,344	27,258,032	4,439,312
436	Sigurime Shëndetësore	4,234,601	4,020,162	214,439
466	Kreditorë për mjete ne ruajtje	9,449,849	29,065,337	(19,615,488)
467	Kreditorë te ndryshëm	2,157,274	3,455,200	(1,297,926)
4341	Operacione me shtetin( detyrime	4,321,625	4,321,625	0

**Llogaria 401-408** “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 14,503,164 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Universiteti më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si më poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Çelje e vitit 2022	2,140,080
Shtesa (K)	12,363,084
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2022 (K)	14,503,164

Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga fatura të palikujduara për mallra dhe shërbime kundrejt furnitorëve, të muajit Dhjetor 2022 në vlerën 14,503,164 lekë (shpenzime operative (602) në vlerën 199,156 lekë dhe shpenzime për investime (231) në vlerën 14,304,008 lekë), në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Llogaria ekonomike	Kod Projekti	Fatura	Shuma	Përshkrimi	Përfituesi
231	19AH806	fat nr.1635/2022, dt 22.12.2022	9,604,320	Shpenzim blerje pajisje elektronike	B...
231	19AH806	fat nr.1662/2022, dt 28.12.2022	4,699,688	Shpenzim blerje pajisje elektronike	B...
602	91105AA	fat nr.58/22, dt 29.12.2022	199,156	Shpenzim materiale sportive	V.K
			<b>14,503,164</b>		

**Llogaria 42**, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 91,062,009 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës, lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten si më poshtë:

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Çelje e vitit 2022	79,582,893
Shtesa (K)	11,553,219
Pakësime (D)	74,103
Gjendja në 31.12.2022(K)	91,062,009

**Llogaria 431**, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 13,625,696 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Çelje e vitit 2022	13,010,785
Shtesa (K)	1,801,437
Pakësime (D)	1,186,526
Gjendja në 31.12.2022 (K)	13,625,696

**Llogaria 435**, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2022 që paguhen në muajin Janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 31,697,344 lekë dhe 4,234,601 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Çelje e vitit 2022	27,258,032
Shtesa	4,451,052
Pakësime	11,740
Gjendja në 31.12.2022	31,697,344
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Çelje e vitit 2022	4,020,162
Shtesa	589,277
Pakësime	374,838
Gjendja në 31.12.2022	4,234,601

**Llogaria 466** “Kreditore për mjete nën ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,065,337 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,449,847 lekë, pakësuar nga viti i shkuar, me vlerën 29,968,130 lekë për shkak të çngurtësimit të garancive të punimeve gjatë 2022, si dhe është shtuar për vlerën 10,352,642 lekë të cilat i korrespondojnë garancive të punimeve që janë marrë gjatë vitit 2022. Për

këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, në Aneksin 1.

**Konstatim:** Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” rezulton e mbartur vlera prej 1,477,393 lekë, e cila përfaqëson garancitë 5% të punimeve të projekteve të projekteve të realizuara gjatë viteve 2009 – 2018. Pavarësisht se projektet kanë përfunduar prej disa viteve tashmë, nga ana e UT – së nuk është kryer ende çngurtësimi i garancisë së punimeve.

**Llogaria 467** “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten detyrime të prapambetura për mallra e shërbime në fund të vitit 2022 në shumën 2,157,274 lekë, të analizuar në Aneksin 2.

- Tejkalim i afatit 30 ditor të likuidimit të detyrimeve.

Nga auditimi i llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, rezultoi se për 80 fatura në vlerën 1,428,274 lekë nuk është respektuar afati i likuidimit të detyrimeve prej 30 ditësh.

Veprime të tilla janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52.

Mangësitë e mësipërme sjellin për pasojë mundësinë e krijimit të detyrimeve të prapambetura për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor të likuidimit të faturave brenda afatit 30 ditor.

**Llogaria 4341** “Operacione me shtetin detyrime”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 4,321,625 lekë dhe rakordon me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

-**Llogaria 7110** përfaqëson të gjitha të ardhurat e krijuara nga UT nga tarifat e shkollimit, regjistrimit, dhe tarifat e shërbimit që ofron UT.

- **Llogaria 6009** pasqyron shtesën në detyrimin për paga, sigurime shoqërore, shëndetësore të vitit 2022 duke zbritur detyrimin për paga dhe sigurime të vitit 2021 dhe gjatë vitit 2022 ka pësuar rritje pasi është rritur niveli i pagave në UT

-**Llogaria 6029** përfaqëson shpenzimet e kryera nga UT (situacioni shpenzimeve llogaria 6029001-6029999) si dhe shpenzimet operative të kryera nga projektet me llogari speciale, detajuar si më poshtë vijon:

6029001	Shpenzime për pritje e përcjellje.	3,412,338
6029002	Shpenzime për aktivitete sociale për personelin	269,964
6029003	Shpenzime gjyqësore	554,546
6029004	Shpenzime për sigurimin e ndërtesave dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme	7,074,372
6029005	Honorare	46,114,515
6029006	Shpenzime kompensimi për anëtarët e Parlamentit dhe zyrtarë të tjerë të zgjedhur	538,271
6029007	Shpenzime për pjesëmarrje në konferenca	20,742,893
6029008	Tatime Taksa	892,477
6029009	Shpenzime për të tjera materiale dhe shërbime operative	4,493,979
	Projekte me llog Speciale	29,081,334
	Totali	113,174,689

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 4,337,422,094 lekë dhe totali shpenzimeve është 2,977,134,868 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 1,360,287,226 lekë rakordon me gjendjen e llog. 85 “Rezultatit e ushtrimit”.

**Konstatim:** Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 1,360,287,226 lekë dhe përfaqëson diferencën absolute mes totalit të operacioneve të të ardhurave me totalin e operacioneve të shpenzimeve. Si tepricë kreditore përfaqëson rezultatit nga funksionimi që rrjedh nga të ardhurat që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në periudhat e mëpasme. Në vitin e mëpasëm vetëm ky efekt do të transferohet në shtesë të fondeve bazë të institucionit.

Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur rezulton me tepricë kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vehte dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie. Nga auditimi rezultoi se referuar akt rakordimit të të ardhurave, Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit", nuk është paraqitur si rubrike me vehte duke zbatuar pjesërisht Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar.

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2022:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 1 "Pasqyra e pozicionit"

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 4,330,352,804 lekë në vitin 2022;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të Formatit nr. 2 "Pasqyra e performancës".

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 4,337,422,094 lekë.

- Llogaria 63 "Ndryshim i gjendjeve të inventarit", evidentuar në Formatin nr.2, për 43,073,291 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 "Gjendja e inventarit" në aktivin e bilancit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 3 "Pasqyra e cash Flow" kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 4,159,301,242 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.5 "Shënimet shpjeguese", japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë,etj);
- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;

- informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.6 “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për UT është 0.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shitesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata (material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shitesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është 2,637,495,763 dhe është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin (Kosto Historike 4,862,790,042 lekë – AA 2,225,294,279 lekë)

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.8 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarive.

Mbyllja e bilancit për vitin 2022 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

### **2.2.2 Auditim i Llogarive Vjetore të Rektoratit të Universitetit të Tiranës për vitin 2023**

Rregullshmëria e përgatitjes, dorëzimi dhe aprovimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2023. Plotësimi i pasqyrave financiare, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financës: janë përfunduar dhe dërguar pasqyrat financiare vjetore në Degën e Thesarit Tiranë me shkresën nr. 858, datë 18.03.2024, dhe konfirmuar nga dega thesarit me nr. 1300/70, datë 19.03.2024. Pra bilanci kontabël i vitit 2023 është përgatitur dhe dorëzuar në afatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe janë firmosur nga nëpunësi autorizues dhe zbatues.

Llogaria vjetore e këtij viti përmban: Aktivin dhe Pasivin, sipas formatit nr.1; Pasqyrën e performancës financiare sipas formatit nr.2; Pasqyrën e flukseve monetare sipas formatit nr.3; Pasqyrën e ndryshimeve në Aktivet Neto/Fondet Neto sipas formatit nr.4; Pyetësin dhe shënimet shpjeguese sipas formatit nr.5 dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën

e Investimeve dhe Burimet e financimit sipas formantit nr.6, Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në Aktivitet e Afatgjata (Kosto Historike) sipas formatit nr.7/a Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlerë Neto) sipas formatit 7/b; si dhe Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave sipas formatit nr.8. Bashkangjitur gjendet dhe relacioni shpjegues për pozicionet e llogarive kontabël të bilancit.

#### **- Inventarizimi**

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar dhe shtrirë për periudhën 2021-2023. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se për vitin 2023 nuk janë realizuar proceset e inventarizimit parashikuar në Paragrafi nr.74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se: “Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës”.

*Mbanë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Administratori i UT z. S. D.*

#### *Më konkretisht:*

Procesi i inventarizimit të aktiveve, për vitin 2021-2022 është kryer nga disa komisioni të ngritur sipas urdhrat të Titullarit të Institucionit “Për krijimin e komisionit të inventarizimit”

#### **- Për vitin 2021**

Në zbatim të urdhrat të Administratorit të UT nr.2767 prot datë 20.10.2021 “Për ngritjen e komisionit dhe kryerjen e inventarizimit të aktiveve, verifikimin fizik dhe cilësorë”.

Komisioni i inventarizimit ka hartuar relacion pa nr prot datë 10.12.2021 mbi inventarin fizik të aktiveve afatgjata materiale, jo materiale dhe financiare të Institucionit ku ka konstatuar se nga inventarizimi rezultojë se nuk ka diferenca si dhe matrialet janë të ruajtura në kushte të mira.

Gjithashtu konstatohet se ka matriale të dëmtuara dhe jashtë funksionit të cilat komisioni propozon të bëhet vlerësimi i këtyre aktiveve.

Me Shkresë 2767/1 prot datë 20.10.2021 është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve i përbërë nga: L.P, Drejtor Finance; F.B, Përgj, sektori Finance dhe A.B, Ekonomiste.

Komisioni i vlerësimit të aktiveve ka hartuar proces-verbal pa nr protokollit datë 20.12.2021 dhe shprehen se pas i verifikuan të gjitha paisjet ku rast pas rast u pa gjendja fizike e tyre e dëmtuar, u konstatua gjendja e papërdorshme e tyre. mosfunksionim etj.

Komisioni ka vendosur ti propozoj Administratorit të UT daljen jashtë përdorimit të listës prej 85 artikujsh me vlerë totale prej 6,030,68 Lekë, vlerë e cila është pa llogaritur amortizimet ne vite.

Ndërkohë që vlera me amortizimin ndër vite në total është 585,559 lekë.

Me shkresë nr. 2048/1, datë 29.07.2021 Bordi i administrimit ka vendosur të miratoj kalimin pa asnjë afekte te aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në UT.

Me shkresë nr. 2767/2 prot datë 20.10.2021 Administratori I UT ka ngritur komisionit për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve i përbërë nga: E.Q; Znj, V.J; J.GJ; B.ZH; E.S.

Me Proces-verbal pa nr prot datë 30.12.2021 komisioni ka kryer procesin e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi:

- U asgjësuan paisjet e dala jashtë përdorimit.

- Asgjësimi u bë me groposje ne vlerën 40.813, asgjësimi pajisjeve elektronike i u dha kompanisë së licensuar në vlerën 544.746 lekë.

- Transporti u krye me furgonat e Rektoratit të UT.

**Grupi i auditimi konstatoi:**

1: Në Universitetin e Tiranës nuk është kryer inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 74, citon: çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

2: Komisioni i vlerësimit të aktiveve i ngritur nga Administratori i UT me nr, 2767/1 prot datë 20.10.2021, në përbërje të tij nuk ka specialist të fushës për të kryer procesin e vlerësimit të aktivet te dëmtuara (pajisje elektronike) në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 99 citon: Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona te cilët janë menaxhere ose specialistë të financës si dhe specialiste te fushes perkatese sipas natyres se aktiveve qe propozohen per dalje nga perdorimi. Kryetar i komisionit te vleresimit eshte Nepunesi Zbatues i njesise.

*Mbanë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet: Administratori i UT z. S. D.*

3: Komisioni i vlerësimit nuk ka kryer një raport analize të aktive te dëmtuara për mundësinë e riparimit por janë mjaftuar vetëm që janë të dëmtuar dhe përshkrimi i dëmtimit. Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Procesi i vlerësimit te aktiveve te propozuara per dalje nga perdorimi ne njësi Pika 95. Është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale, dhe piken 103.

*Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: L.P, F.B, A.B.*

4: Në proces-verbali datë 30.12.2021 të mbajtur nga komisioni për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit, nuk ka gjurme auditimi mbi asgjësimin e aktiveve, nuk ka foto të bashkangjitura për të vërtetuar groposjen dhe asgjësimin e aktiveve në vlerën 40,813 lekë.

Ndërkohë që asgjësimi i aktiveve duhet të kryet pranë kompanive të licensuarara për menaxhimin mbetjet dhe jo te groposen ne tokë në kundërshtim Ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” Neni 61, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 108, 109 dhe 122.

Më proces-verbal pa nr prot datë 30.12.2021 i janë dorëzuar pajisjet elektronike për asgjësim kompanisë Green Recycling ne vlerën 544,746 lekë, por përsëri mungon gjurma e auditimit pasi nuk ka foto bashkangjitur për të vërtetuar dorëzimin e pajisjeve elektronike.

Në kundërshtim Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 122.

Për sa më sipër vlera prej 40,813 lekë për aktivet të cilat janë asgjësuar me groposje përbën dem ekonomi, pasi siç e kemi cituar dhe me sipër nuk ka gjurme auditimi për asgjësimin e aktiveve.

*Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: E.Q, V.J, J.GJ, B.ZH, E.S.*

**- Për vitin 2022**

Në zbatim të urdhrat të Administratorit të UT nr.3291 prot datë 01.12.2022 “Për ngritjen e komisionit dhe kryerjen e inventarizimit të aktiveve, verifikimin fizik dhe cilësorë”.

Komisioni i inventarizimit pavarësisht se ka realizuar procesin e inventarizimit nuk ka përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike

dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për vlerësim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme drejtuesit.

Gjithashtu nuk është kryer inventarizimi i gjendjes së sasive të karburantit, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 74, citon: çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, dhe pika 85 germa c citon: Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: Te përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues.

*Mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe mos veprimet e tyre: A.B, T.A dhe D.K.*

Observacion i subjektit mbi Projekt Raportin e Auditimit, vënë në dispozicion grupit të auditimit në datë 10.09.2024 me nr.103/22 prot.

**Pretendimi i subjektit:**

*1. Universiteti i Tiranës është dakord me rekomandimin e lënë nga KLSH-ja, Administratori i UT-së do të marrë masat, për të kryer inventarët të paktën një herë në vit, duke caktuar në përbërje të komisioneve të inventarizimit të aktiveve specialistë të fushës, me qëllim kryerje të inventarizimit me cilësi, duke pasqyruar drejtë inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve. Gjatë procesit të inventarizimit të verifikohet gjendja e lëndës djegëse në çisternat e karburantit për secilin nga kaldajat dhe dhe gjeneratorin e UT-së. Kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre të shoqërohen me procesverbalet e nxjerrjes jashtë përdorimit në përputhje me parashikimet e UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.*

*2. Për sa konstatojnë dëmi ekonomik në vlerën 40.813 lekë për asgjësimin e aktiveve të tjera afatgjata, ju bëjmë me dije se veprimet janë kryer duke respektuar hapat e përcaktuara në Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndyshuar dhe nuk mund të ndiqnim procedura të tjera të tjetërsimit pasi vlera e mbetur e aktiveve të dala jashtë përdorimit ishte shumë e vogël siç dhe ju e keni verifikuar.*

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**

Për sa i përket pikës 1 të observacionit nga ana e UT janë pranuar rekomandimet e grupit të auditimit. Ndërsa referuar pikës nr. 2, observacionet e ardhura me nr. 103/22 prot datë 09.09.2024, nuk u sollën arsyetime apo dokumenta shtesë vërtetues për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

➤ **Nga verifikimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 rezultoi:**

**a. Analiza e pasqyrës së pozicionit financiar:**

Zëri Aktive paraqitet për lekë

Shuma e aktivitetit të pasqyrës financiare pasqyron aktivitetet e qëndrueshme, aktivitetet qarkulluese kërkesat për t'u arkëtuar dhe mjete monetare në llogarinë e thesarit që i shërbejnë institucionit për zhvillimin e aktivitetit të tij.

Nga të dhënat përmbledhëse të Aktivitetit të Pasqyrës Financiare të vitit ushtrimor të vitit 2023, rezulton se totali i aktivitetit me 31.12.2023 paraqitet me vlerën 691,167,235 lekë dhe se, “Aktive të qëndrueshme”, zënë 42% të vlerës totale të aktivitetit ndërsa, Aktivitetet Qarkulluese zënë 58% të vlerës

totale. Aktivet e Qëndrueshme në krahasim me vitin 2022, janë pakësuar në vlerën 4,284,102 lekë ndërsa, Aktivet Qarkulluese janë shtuar në vlerën 85,636,277 lekë

Aktive Afatshkurtra. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatshkurta dhe pasqyrohet në shumën lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “Mjeteve monetare dhe ekuivalente të tyre” me “Gjendje inventarit qarkullues”, “Llogarive të arkëtueshme” dhe “Të tjera aktive afatshkurtra”

- Përbërës të këtij posti janë llogaritë:

1. Mjete monetare dhe ekuivalentet të tyre me vlerë 346,310,099 lekë e cila është shtuar nga viti shtuar me 74,677,711 lekë dhe përbëhet nga:

Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” me vlerën prej 346,310,099 lekë e cila është shtuar nga viti shtuar me 74,677,711 lekë.

Kjo llogari është e barabartë me shumën e të ardhurave për t’u trashëguar në vitin 2024 në vlerën 205,325,179 (Kapitulli 08) dhe 131,847,913 (Kapitulli 06) me gjendjen e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 9,137,005 lekë, të cilat përfaqësojnë ngurtësimet e garancive të punimeve në masën 5%. Në përputhje me pikën 50 të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, llogaria 520 është rakoduar me thesarin, dhe në aktrakordim, tepricat paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara.

2. **Gjendje Inventari Qarkullues me vlerën 16,267,893 lekë.**

Totali i llogarisë Gjendje inventari qarkullues ka pësuar një pakësim me 3,841,902 lekë nga viti i shkuar 2022. Nga krahasimi i të njëjtave poste për dy vitet, rezulton se diferenca e gjendjeve të inventarëve në fund të dy viteve, përputhet me efektin debitor të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së materialeve“ në Pasqyrën e performancës.

Në përbërje të kësaj llogarie janë:

- **Llogaria 31 “Materiale”** me vlerë 3,841,902 lekë, pakësuar nga viti i shkuar me 3,841,902 lekë, dhe pasqyron gjendjen e inventarit më datë 31.12.2023.

3. **Llogari të arkëtueshme me vlerë 40,898,827 lekë** e cila përbëhet nga:

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 4,321,625 lekë, llogari e cila paraqitet e pandryshuar nga viti i kaluar dhe përbëhet nga detyrime të arkëtueshme të krijuara që nga viti 2010 – 2018.

Nga Rektorati i Universitetit të Tiranës, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e debitorëve të krijuar nga vitet 2010-2018 , në vlerën 4,321,625 lekë. Në pasqyrat financiare janë paraqitur të drejta që i përkasin periudhave të mëparshme duke i kaluar dhe afatet e parashkrimit, të drejta për të cilat nuk disponojnë dokumente ligjore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, pika 3, germa “g”.

Mangësitë e mësipërme sjellin për pasojë kalimin i afatit të parashkrimit të detyrimeve të arkëtueshme për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor për mbledhjen e detyrimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 197/50 prot., datë 06.09.2024 “Observacioni mbi Projekt Raportin e Auditimit protokolluar në KLSH me shkresën nr. 103/22 prot., datë 09.09.2024, ku janë shprehur se:

**Pretendimi i subjektit:**

Universiteti i Tiranës është dakord me rekomandimin e lënë nga KLSH-ja, Administratori i UT-së do të marrë masat, dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar arkëtimin e debitorëve. Për debitorët pa shpresë arkëtimi, do të verifikohet dhe evidentohet realisht statusi dhe mundësia për arkëtimin e detyrimit, dhe më pas do të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrave financiare.

**Komenti i grupit të auditimit:**

Observacioni i mësipërm pranohet.

**Llogaria 4342** “Operacione me shtetin (Të drejta)”, me vlerë 36,577,202 lekë shtuar nga viti shtuar me 14,800,496 lekë, kjo llogari përfshin detyrimet afatshkurtra për pagesën e punonjësve për muajin Dhjetor 2023 në vlerën 6,594,695, pagesën e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore po për këtë muaj në vlerën 5,065,079 lekë dhe detyrime për furnitorë të muajit Dhjetor 2023 në vlerën 24,917,428 lekë detajuar si më poshtë vijon:

Llogaria ek	Përshkrimi llogarisë	Shuma
401	Furnitore e llogari te lidhura me to	24,917,428
42	Detyrime ndaj personelit	6,594,695
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,753,091
435	Sigurime Shoqërore	2,029,538
436	Sigurime Shëndetësore	282,450
Totali		36,577,202

Aktive Afatgjata. Totali i kësaj rubrike përfaqëson vlerën neto të aktiveve afatgjata dhe pasqyrohet në vlerën 287,690,416 lekë, e cila ka dalë si shumë e përgjithshme e llogarive “aktive afatgjata jomateriale”, “aktive afatgjata materiale” dhe “Investime”.

- *Përbërës të këtij posti janë llogaritë:*

**Llogaria 20** “Aktive Afatgjata Jomateriale”, me vlerë totale prej 69,179,131 lekë, e cila përbëhet nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në vlerën 69,179,131 lekë shtuar nga viti i kaluar me 2,479,985 lekë për efekt të kryerjes së studimeve gjatë vitit 2023 dhe e detajuar si më poshtë vijon. Konstatohet se studim & projektim për ndërtimin e kampusit të UT është kryer në vitin 2011, por projekti nuk është realizuar asnjëherë për shkak të problemeve me pronësinë.

Analiza e llogarisë 202 “Studime projektme”	Çelja 01.01.2023	Amortizim akumuluar 01.01.2023	Shtesa gjatë vitit 2023	Paksime gjatë vitit	Amortizim akumuluar	Gjendja HISTORIKE me 31.12.2023	Amortizim akumuluar 31.12.2023	Gjendja NETO me 31.12.2023	Viti hyrjes	Vlera Hyrje
Rektorati "Studim projektim "Kampusi I UT"	99,720,000	29,510,373			3,386,482	99,720,000	32,896,855	66,823,145	2011	99,720,000
Hartim projekt për efic e energjise FD			1,260,000		63,000		63,000	1,197,000	2023	1,260,000
Shpz Oponence tek P.pv eficences Enenergjise FD			131,360		6,568		6,568	124,792	2023	131,360
Hartim projekt për efic e energjise UT			828,000		41,400		41,400	786,600	2023	828,000
Shpnz oponence			260,625		13,031		13,031	247,594	2023	260,625

Analiza e llogarisë 202 “Studime projektive” tek obj rish shtese kati fshs	Çelja 01.01.2023	Amortizim akumuluar 01.01.2023	Shtesa gjatë vitit 2023	Paksime gjatë vitit	Amortizim akumuluar	Gjendja HISTORIKE me 31.12.2023	Amortizim akumuluar 31.12.2023	Gjendja NETO me 31.12.2023	Viti hyrjes	Vlera Hyrje
Total	99,720,000	29,510,373	2,479,985	-	3,510,482	99,720,000	33,020,855	69,179,130		

**Llogaria 21** “Aktive Afatgjata Materiale”, me vlerë totale prej 218,511,285 lekë pakësuar nga viti i shkuar me 6,764,087 lekë, përbëhet nga:

**Llogaria 212** “Ndërtim e konstruksione”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 136,456,049 lekë, shtuar me 47,190,096 lekë (sipas aneksit bashkëlidhur). Në përbërje të llogarisë 212 është Godina e Rektorarit dhe Godina e Liria, të cilat i janë kaluar në administrim Universitetit të Tiranës në përputhje me VKM nr. 430, datë 02.07.2014, i ndryshuar. Shtesat në këtë llogari i korrespondojnë investimeve të kryera gjatë vitit 2023 për llogari të:

1. Fakultetit të Drejtësisë, sipas kontratës nr.2308/11, dt 26.09.2023.
2. Kolaudimi i punimeve në UT; FHF; IFBZ dhe UT
3. Mbikëqyrja e punimeve në UT; FSHN; FHF dhe IFBZ
4. Fakulteti Histori Filologjisë dhe Fakulteti i Ekonomisë sipas kontratës nr. 1683/8, datë 15.09.2023.

Këto vlerë janë kontabilizuar në aktivet e UT deri në çlirimin e garancisë 5% të këtyre projekteve dhe në vijim vlera do të kalojë për llogari të Fakulteteve përkatëse.

**- Nga auditimi rezultoi se:**

1- UT për pronat e kaluara në administrim në përputhje me VKM nr. 430, datë 02.07.2014, i ndryshuar, konkretisht për godinën e Rektoratit dhe Godinën Liria, nuk disponon ende certifikatë pronësie, por është në proces regjistrimi të tyre. Me shkresën nr. 02/1 prot. datë 23.01.2024, Administratori i UT ka informuar Ministrinë e Arsimit se për një pjesë të pasurive në administrim të UT, ku përfshihen dhe dy pasuritë e mësipërme, procedura e regjistrimit është në proces, por ende nuk është përfunduar, veprimet në kundërshtim VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar pika 2 dhe 9

Situata e cituar më sipër sjell për pasojë mangësi në formalizimin e marrëdhënies së institucionit me asetet e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” për shkak të mungesës së disponimit të titujve të pronësisë.

2- Periudha e hyrjes dhe regjistrimit të asetëve në aktivet e Universitetit të Tiranës është shumë e largët në krahasim me periudhën aktuale. Gjatë kësaj kohe nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të asetëve me qëllim për afrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin sikurse parashikohet në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”, duke sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Financiare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivitetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”

Mangësitë e mësipërme sjellin për pasojë pasqyrim jo të saktë të vlerës reale të aktiveve të institucionit për shkak të mos kryerjes së procesit të rivlerësimit të aktiveve.

**Llogaria 214** “*Instalime Teknike makineri, pajisje*”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 51,798,461 lekë dhe krahasuar me vitin paraardhës është pakësuar me vlerën 46,389,990 lekë. Shtesat e vitit reflektojnë të gjitha blerjet që janë kryer nga Rektorati për nevojat e Fakulteteve dhe pakësimet pasqyrojnë shpërndarjen e mëtejshme të këtyre blerjeve në fakultetet përkatëse. E detajuar kjo llogari është si më poshtë vijon:

C	Përshkrimi	Gjendje 01.01.2023	Amortizimi akumuluar	Shtesa viti 2023	Pakësimi vitit 2023	Amortizimi vjetor	Vlera Historike 21.12.2023	Amortizim akumuluar 31.12.2023	Vlera Neto 31.12.2023
214	Pajisje elektronike (Kompjuter , lap top, printer fotokopje etj.)	217,437,653	119,249,203	85,098,463	106,941,340	24,547,113	195,594,776	143,796,315	51,798,461
	Shuma Totale								

**Llogaria 215** “*Mjete Transporti*”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 891,521 lekë, pakësuar nga viti i kaluar me 222,880 lekë si rrjedhojë e amortizimit të aplikuar në masën 20%, e detajuar si më poshtë vijon:

Nr.	Emërtimi I objektit	Viti blerjes	Gjendja Kontabël	Vlera Historike	Amortizimi akumuluar 01.01.2023	Amortizimi vjetor	Amortizimi akumuluar 31.12.2023	Vlera Neto	
			sasia						çmimi
1	Minibus KIA (TR3439K) vit prodh 2003	2004	1	1,990,000	1,990,000	1,787,654	40,469	1,828,123	161,877
2	MINIBUS VË TRANSPORT TR 7863 M vit prodhimi 2006	2006	1	3,470,000	3,470,000	3,103,046	73,391	3,176,437	293,563
3	Makine tip hundai tr4085 u	2007	1	2,991,981	2,991,981	2,583,494	81,697	2,665,191	326,790
4	IVECO fiat Turbo daily Tr 7894 A vit prodh	1992	1	2,140,000	2,140,000	2,107,952	6,410	2,114,362	25,638
5	NISAN PATROL Tr 9925E vit prodh 1995	2001	1	1,600,000	1,600,000	1,495,433	20,913	1,516,347	83,653
	Totali				12,191,981	11,077,580	222,880	11,300,460	891,521

**Llogaria 218** “*Inventar ekonomik*”, paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën prej 29,365,255 lekë dhe krahasuar me vitin paraardhës është pakësuar me vlerën 4,894,897 lekë, ku ndikim kanë patur amortizimi vjetor në masën 25%, si dhe blerjet që janë kryer nga Rektorati për nevojat e Fakulteteve dhe shpërndarjen e mëtejshme të këtyre blerjeve në fakultetet përkatëse, detajuar si më poshtë vijon:

Llog ek	Pershkrimi	Gjendje 01.01.2023	Amortizimi akumuluar	Shtesa viti 2023	Pakesime vitet 2023	Amortizimi vjetor	Vlera Historike 21.12.2023	Amortizim akumuluar 31.12.2023	Vlera Neto 31.12.2023
218	Pajisje tjera (audio vizuale, kamera servera etj)	40,216,878	22,425,561			3,558,263	40,216,878	25,983,824	14,233,053
218	Pajisje mobilimi (tavolina karrige, dollap)	21,365,913	9,611,607	26,629,620	26,629,620	2,350,861	21,365,913	11,962,468	9,403,444
218	pajisje tjera (chiller, kondicioner, )	14,330,017	7,169,070	5,037,600	5,037,600	1,432,189	14,330,017	8,601,260	5,728,757
218	Pajisje te tjera ( lab , libra) – Blerje për univesitetet			37,301,376	37,301,376				
	Shuma Totale	75,912,807	39,206,239	68,968,596		7,341,314	75,912,807	46,547,552	29,365,255

### **Pasivi**

Duke analizuar pasivin e bilancit të këtij viti dhe duke e krahasuar me një vit më parë, rezulton se llogaritë pasive janë shtuar në krahasim me një vit më parë me 14,487,625 lekë, ndërsa me klasa dhe llogari rezultojnë si më poshtë:

Llogaritë e detyrimeve afatshkurtra, në vlerën 50,035,832 lekë shtuar nga viti i kaluar në vlerën prej 14,487,625 lekë, si më poshtë:

**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”,** në vlerë 24,917,428 lekë detajuar si më poshtë vijon:

Kap.	Llogaria Ekonomike	Nen Llogaria	Shuma	Pershkrimi	Perfituesi	Fatura:
1	231	2318600	3,520,800	blerje Furnizim vendosje mallrash për proj SMART	B.	fat nr.1652/2023, dt 26.12.23,fat korrigjuese nr.1680/23
6	231	2312112	5,796,292	Blerje LIBRA	E. C.	fat nr.1783/23, dt 28.12.2023
1	231	2318600	8,275,800	Blerje paj pajisje elektronike proj MAS didaktike -mesimore	D.	fat nr. 64/23, dt 18.12.23
1	231	2318600	1,600,000	Blerje pajisje lab për projektin	D.	fat nr.306/2023, dt 22.12.23
8	602	6020100	1,248,157	Blerje tonera	I. SHPK	ft nr.18251/23, dt 22.12.23
8	602	6020100	1,299,464	Blerje tonera	I. SHPK	ft nr.18452/23, dt 27.12.23
8	602	6020100	3,092,338	Blerje tonera	I. SHPK	ft nr.18558/23, dt 28.12.23
8	602	6021099	66,666	shpenzime BOTIME proj masr FHF	A. P.	fat nr.29/23, dt 13.12.23
8	602	6020100	17,911	Abonim shtypi	P.	Fature 661/2023 date 14.11.2023
			<b>24,917,428</b>			

**Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”,** në vlerën 6,594,695 lekë e cila përfaqëson për pagesën e punonjësve për muajin Dhjetor 2023.

**Llogaria 431 “Detyrime ndaj Shtetit për tatim-taksa”** në vlerën 2,753,091 lekë, përfaqëson detyrimet e Institucionit ndaj degës së Tatimeve për tatimin mbi pagat e punonjësve për pagat dhe honoratet për muajin Dhjetor 2023.

**Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore “** në vlerën 2,029,538 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror të muajit Dhjetor 2023, e cila likuidohet në muajin Janar 2024.

**Llogaria 436 “Sigurime Shëndetësore “** në vlerën 282,450 lekë, përfaqëson kontributin e sigurimit shëndetësore të muajit Dhjetor 2023, e cila likuidohet në muajin Janar 2024.

**Llogaria 466** “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 9,137,005 lekë është pakësuar nga viti i shkuar, me vlerën 312,844 lekë për shkak të çngurtësimit të garancive të punimeve të kryera në vitin 2022 në vlerën 1,255,305 lekë, si dhe është shtuar për vlerën 942,463 lekë të cilat i korrespondojnë garancive të punimeve që janë marrë gjatë vitit 2023. Kjo vlerë është detajuar në Aneksin 3.

**Konstatim:** Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” rezulton e mbartur vlera prej 1,477,393 lekë, e cila përfaqëson garancitë 5% të punimeve të projekteve të realizuara gjatë viteve 2013 – 2021 dhe për të cilat nuk ka informacion se përse janë mbajtur këto fonde për një periudhë disa vjeçare pas përfundimit të projektit.

**Llogaria 4341** “Operacione me shtetin (Të drejta)” me vlerë 4,321,625 lekë e cila korrespondon me llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe është e pandryshuar për arsye se nuk janë mbyllur proceset gjyqësore për këto debitorë.

**-Llogaritë 101** “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar”, në vlerën 307,800,211 lekë. Këto fonde i përgjigjen pjesës së aktivitetit të bilancit.

**Konstatim:** Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit” në vlerën 333,331,192 lekë dhe përfaqëson diferencën absolute mes totalit të operacioneve të të ardhurave me totalin e operacioneve të shpenzimeve. Si tepricë kreditore përfaqëson rezultatin nga funksionimi që rrjedh nga të ardhurat që institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) për t’u trashëguar në periudhat e mëpasme. Në vitin e mëpasëm vetëm ky efekt do të transferohet në shtesë të fondeve bazë të institucionit. Llogaria 85 "Rezultati i ushtrimit nga funksioni" kur rezulton me tepricë kreditore, përfaqësohet si rubrikë me vehte dhe përbën rezultatin nga viti ushtrimor si tepricë kreditore e kësaj llogarie. Nga auditimi rezultoi se referuar akt rakordimit të të ardhurave, Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, nuk është paraqitur si rubrike me vehte duke zbatuar pjesërisht Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

## b. Auditimi i llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve (Pasqyra e performancës)

### Mbi të ardhurat:

Nr.	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI	VITI	Ndryshimi
		USHTRIMOR	I MEPARSHEM	
b	c	1	2	3
A	TE ARDHURAT	705,191,076	612,388,777	92,802,298
70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0	0
700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	0	0	0
702	2.Tatimi mbi Pasurine	0	0	0
703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	0	0	0
704	4.Takse mbi tregtine dhe transakcionet nderkombtare	0	0	0
705	5.Takse e rruges			0
708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare			0
709	7.Gjoba e Kamat vonesa			0
75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE	0	0	0
71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	3,517,031	4,401,885	-884,854
710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia	0	0	0
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	3,517,031	4,401,885	-884,854

7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	3,517,031	4,401,885	-884,854
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore			0
76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0	0
72	V.GRANTE KORENTE	701,674,045	607,986,892	93,687,153
720	1.Grant korent I Brendshem	701,674,045	607,986,892	93,687,153
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	534,156,557	465,353,145	68,803,412
7205	Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit	139,141,583	120,182,625	18,958,958
7206	Financim I pritshem nga buxheti	17,384,310	7,472,725	9,911,585
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	10,991,595	14,978,397	-3,986,802
721	2.Grant korent I Huaj	0	0	0
	VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0	0
73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE			0

Klasa 7 të ardhurat e ushtrimit. Në këtë pasqyrë të ardhurat paraqiten në shumën 705,191,076 lekë, ky total është i rakorduar me “Shpenzime të shfrytëzimit” dhe “Llogaritë Debitorë”. Të ardhurat e janë të detajuara në llogaritë si vijon:

**Llogaria 711** “Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare” në vlerën 3,517,031 lekë, pakësuar nga viti i kaluar në vlerën 884,854 e cila përfaqëson të ardhurat që ka krijuar Rektorati nga shërbimet që ofron (konfirmim dokumentacioni, ndryshim mbiemri etj.).

**Llogaria 72.** V “Grante Korente” në total prej 701,674,045lekë shtuar nga viti i shkuar me 93,687,153 lekë. Kjo llogari përbëhet nga:

- **Llogaria 7200** “Nga buxheti për NjQPQ” për vlerën 534,156,557 lekë, shtuar nga viti shkuar me 68,803,412 lekë, detajuar si më poshtë vijon:

	Buxheti	Sipas evidencës
1	Buxheti trashëguar vitit 2022	134,856,803
2	Buxheti I akorduar 2023	406,772,479
A	Total Buxheti	541,629,282
B	Financim pritshem për detyrimet dhjetor 2022	7,472,725
A-B	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	534,156,557

- **Llogaria 7205** “Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit”, me vlerë prej 139,141,583 lekë të cilat përfaqësojnë shumën e transfertave të fakulteteve për llogari të Rektoratit të UT-së për likuidimin e kontratave të lidhura; si dhe të ardhurat e trashëguara të vitit 2022, pakësuar me fondin e caktuar për investime 2023.

- **Llogaria 7206** “Financim i pritshëm nga Buxheti”, me vlerë prej 17,384,310 lekë, shtuar gjatë këtij viti me 9,911,585 lekë dhe përfaqëson të drejta të njësisë në marrëdhënie me shtetin.

- **Llogaria 7206** “Sponsorizime të brendshme (nga të tretë)” me vlerë prej 10,991,595 lekë.

Janë mbajtur aktet e rakordimit për të ardhurat e vitit 2023, nënshkruar nga specialist i financës A.B, përgjegjësi i sektorit të financës L. P, specialistja e Degës së Thesarit K.XH dhe Përgjegjësi i sektori të të ardhurave të degës së Thesarit SH.C. Sipas rakordimeve të kryera, të ardhurat vjetore të arkëtuara gjatë vitit janë 139,114,760 lekë, nga të cilat janë derdhur në buxhet 34,248 lekë dhe janë autorizuar për përdorim nga institucioni 139,080,512 lekë.

#### - **Mbi shpenzimet**

Në këtë format janë përfshirë shpenzimet faktike nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor 2023. Pra situacionit vjetor i është zbritur pagesa e detyrimeve të muajit Dhjetor, deri më 31 Dhjetor 2023 në bilancin kontabël, dhe i janë shtuar detyrimet të cilat kanë ngelur të prapambetura nga 31.12.2022.

Në pasqyrën e shpenzimeve të periudhës ushtrimore, formati nr. 3/1 janë të pasqyruara shpenzimet korrente të konstatuara si dhe ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën 3,841,902 lekë, të ndara sipas zërave si:

**-Llogaria (600)** “Paga, shpërblime e të tjera shpenzime personeli” në vlerën 93,827,291 lekë ose 25 % të totalit të shpenzimeve, për periudhën 01 janar deri 31 dhjetor 2023.

**-Llogaria (601)** “Kontribute për sig. Shoqërore e shëndetësore” në vlerën 15,515,739 lekë ose 4 % të totalit të shpenzimeve.

**-Llogaria (602)** “Mallra dhe shërbime të tjera” në vlerën 253,262,015 lekë ose 68 % të totalit të shpenzimeve, ku janë paraqitur të gjitha shpenzimet e kryera dhe të faturuara në vitin 2023.

**-Llogaria (604)** “Transferime korrente të brendshme” në vlerën 3,682,910 lekë ose 0.99% të totalit të shpenzimeve.

**-Llogaria (605)** “Transferime korrente me jashtë” në vlerën 1,592,187 lekë ose 0.43 % të totalit të shpenzimeve.

**-Llogaria (606)** “Transferta për buxhete familjare e individët” në vlerën 137,840 lekë ose 0.04 % të totalit të shpenzimeve.

**-Llogaria (63)** “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në vlerën 3,841,902 lekë, përfaqëson ndryshimin e gjendjes së inventarit në magazinën e materialeve dhe objekteve të inventarit të imët në përdorim të punonjësve. Ky ndryshim është regjistruar në llog. 8423 “transferim për ndryshim gjendje inventari” në pasqyrën e shpenzimeve të ushtrimit në vlerën e mësipërme.

Nga grupi i auditimit u krye rakordimi i shpenzimeve të pasqyrës 3/1 me thesarin dhe u konstatuan diferenca ndërmjet vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe akt rakordimi me thesarin, për shkak se zbriten detyrimet e muajit Dhjetor 2022 dhe shtohen detyrimet e muajit Dhjetor 2023. Pasqyra krahasuese si më poshtë:

Nr. Llog	Shpenzimet e ushtrimit	Pasqyrat financiare	Rakordimi me thesarin	Diferenca
60	I. Shpenzime Korrente	368,017,982	358,106,396	9,911,586
600	Paga, shpërblime e të tjera personeli	93,827,291	91405359	2,421,932
601	Kontrib.te sig.shoq.e shendets.	15,515,739	15116331	399,408
602	Mallra dhe shërbime te tjera	253,262,015	246171768.7	7,090,246
604	Transferime korentek tek Organizatat jo fitimprurse	3,682,910	3682910	-
605	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit	1,592,187	1592187	-
6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	137,840	137840	-

#### Sqarim i Diferencave:

Llog ek	Detyrim paga Dhjetor 22	Detyrime paga Dhjetor 2023	Diferenca
600	6,068,229	8,490,161	2,421,932
601	1,005,139	1,404,547	399,408

Llog ek	Detyrim TB dhjetor 22	Detyrim 22 Furnitor 602	Detyrime TB 2023	Detyrim 23 Furnitor 602	Diferenca
602	(200,200)	(199,156)	1,765,066	5,724,536	7,090,246

Vlerësimi nëse aktivi dhe pasivi janë llogaritur drejtë dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse si dhe rakordimi me pasqyrat e tjera financiare.

#### - Përsa i përket rakordimit të pasqyrave financiare për vitin 2023:

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 1 “Pasqyra e pozicionit”

-Totali i aktiveve është i barabartë me totalin e pasiveve të bilancit kontabël, në shumën 691,167,235 lekë në vitin 2023;

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

- Auditimi i barazisë në vlera të Formatit nr. 2 “Pasqyra e performancës”

Të ardhurat e paraqitura në formatin nr.2 janë të barabarta me shpenzimet e paraqitura në po këtë format plus Teprica/Deficiti i periudhës nga pikëpamja e shumave, përkatësisht 705,191,076 lekë ( 371,859,884 + 333,331,192).

- Llogaria 63 “Ndryshim i gjendjeve të inventarit”, evidentuar në Formatin nr.2, për 3,841,902 lekë, rakordon me ndryshimin e gjendjes të magazinës dhe është sa diferenca e klasës 2 “Gjendja e inventarit” në aktivin e bilancit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 3 “Pasqyra e cash flow” kjo pasqyrë jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet në mjetet monetare apo ekuivalentet e tyre (llogaritë financiare të klasës 5). Në fund, kjo pasqyrë tregon shtimin apo pakësimin neto të mjeteve monetare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, të shkaktuar nga kryerja e veprimtarive të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.4 “Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto” kjo pasqyrë na jep informacion në lidhje me gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve dhe fondeve neto të njësisë gjatë vitit ushtrimor të mbyllur. Totali i fondeve të vet të kësaj pasqyre duhet të jetë i barabartë me totalin e aktiveve/fondeve neto të evidentuar në rubrikën C të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar, konkretisht për 641,131,403 lekë.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.5 “Shënimet shpjeguese”, japin informacion të përgjithshëm në lidhje me njësinë (emërtimin e njësisë, emërtimin e njësisë eprore, NIPT-in e njësisë, kodin e njësisë, adresën apo dhe një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë së tij);

- informacion shpjegues të përgjithshëm në lidhje me paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore (datën e paraqitjes në degën e thesarit, plotësia e këtyre pasqyrave të paraqitura, përfshirja e të gjitha njësive të vartësisë,etj);
- informacion në lidhje me rakordimet financiare ndërmjet zërave të ndryshëm të pasqyrave financiare vjetore të njësisë;
- informacion në lidhje me elementë specifike të pasqyrave financiare të dorëzuara; si dhe informacion në lidhje me problemet e ndryshme që mund të kenë rezultuar gjatë përgatitjes dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.

Nga auditimi u konstatua se, plotësimi i këtij formati nga ana e institucionit ishte i plotë

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.6 “Investimet dhe Burimet e financimit”. Balanca mes burimeve për investime dhe shpenzimeve për investime duhet të jetë si rregull më e madhe ose e barabartë me zero, dhe për UT është 0.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përse i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme (kosto neto)”, jep informacion të analizuar për gjendjen në fillim të periudhës, ndryshimet (shitesat e pakësimet) gjatë periudhës ushtrimore të mbyllur në aktivet afatgjata

(material e jomateriale) me vlerën historike të tyre si dhe gjendjen në fund të periudhës.

Vlera neto për gjendjen në fillim të periudhës ushtrimore, për shtesat gjatë periudhës ushtrimore, për pakësimet gjatë periudhës ushtrimore dhe për gjendjen në fund të periudhës ushtrimore, është 287,690,416 dhe është e barabartë me vlerën historike të aktiveve duke i zbritur amortizimin (Kosto Historike 581,854,011 lekë – AA 294,166,595 lekë)

Sa më sipër, nuk u konstatuan mospërputhje përsa i përket kësaj llogarie.

-Auditimi për barazimin e vlerës totale të Formatit nr.8 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”, siguron një informacion të saktë mbi numrin e punonjësve, ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, fondin e pagave, shpërblimet suplementare dhe shpërblime të tjera, kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Tatimet e të ardhurave personale. Është plotësuar nga burimet njerëzore pjesa për gjendjen në fillim, lëvizjet dhe gjendjen në fund të punonjësve, ndërsa pjesa për fondin e pagave është e plotësuar sipas të dhënave nga pasqyra e shpenzimeve.

Kjo pasqyrë është e rakorduar me të dhënat e paraqitura në llogarinë 600 të formatit nr.2 Shpenzime të Shfrytëzimit.

Sa më sipër, nuk u konstatua mospërputhje përsa i përket këtyre llogarive.

Mbyllja e bilancit për vitin 2023 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 neni 6, me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël” si dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NjQP”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

### **2.3. Vlerësimi i funksionimit të sistemit të brëndshëm dhe menaxhimit financiar.**

Auditimit, u fokusua kryesisht në këto çështje:

- ☞ Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit
- ☞ Menaxhimi i riskut
- ☞ Veprimtaritë e kontrollit
- ☞ Informim komunikimi
- ☞ Monitorimi

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Universiteti i Tiranës, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

#### **-Komponenti “Mjedisi i kontrollit”**

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikat menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën

organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 1 – Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike;

Parimi 2 – Titullari/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje;

Parimi 3 – Titullari/ Njësia Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë;

Parimi 4 – Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave;

Parimi 5 – Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Universitetit të Tiranës në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në zbatimin e nenit 20, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, nga auditimi si dhe referuar në pyetësorët e vetëvlerësimit të plotësuar nga UT për periudhën objekt auditimi (vitet 2021, 2022 dhe 2023), rezultoi se:

- UT me Vendim Rektorati nr.4, datë 24.01.2022 ka miratuar në parim rregulloren e brendshme të punës “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Rektoratit të Universitetit të Tiranës”.

- UT me Vendim Senatit Akademik nr.20, datë 27.07.2022 ka miratuar “Rregulloren e Universitetit të Tiranës”, ku ka pasur një ndryshim në rregullore me Vendimin e Senatit Akademik nr.17, datë 27.02.2023.

Përsa i takon problematikave dhe marrjen e masave kundër tyre, rastet ndiqen duke u bazuar në procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislativën për Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës dhe Legjislativën për Arsimin e Lartë në RSH.

-Në lidhje me ankesat për korrupsion rezultoi se kushdo është i lirë të shkruajë dhe të dorëzojë ankesë verbalisht ose shkresërisht pranë organeve drejtuese të UT-së. Ankesat mund të bëhen edhe nëpërmjet adresës elektronike në faqen e Eëb-it.

-Nga auditimi rezultoi se në kundërshtim me nenin 5 të Rregullores mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ, në të tre vitet objekt auditimit për të gjithë punonjësit e UT-së sipas varësisë drejtoria përkatëse nuk plotëson formularin e performancës. Vlerësimi i performancës në punë është procesi i realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara si dhe vlerësimi i sjelljeve në përputhje me kodin e etikës.

-Në nenin 75,76 dhe 87 të Statutit të UT-së është parashikuar përgjegjësia disiplinore për personelin akademik, ndihmësakademik dhe atë administrativ. Gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka patur raste të raportuara nga studentët për shkelje të etikës

-Nga auditimi i përgjigjeve të dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit, konstatohet se institucioni për vitin 2021 ka vepruar mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar në Senat dhe KADM me vendimin nr.5, datë 12.04.2010. Në vitin 2022 e në vazhdim ka vepruar në bazë të rregullores së re të miratuar me vendim nr.20 datë 27.07.2022 e cila ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative të UT. Përsa i takon organizimit dhe funksionimit të administratës së Rektoratit të UT është miratuar me udhërin e brendshme të Rektorit nr.17, datë 18.12.2012 rregullorja e brendshme e punës.

-Kodi i Etikës është miratuar me vendim nr.12 datë 18.04.2011 të Senatit Akademik të UT, në mbështetje të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligji nr. 9741, si dhe ligjit për arsimin e lartë të asaj periudhe, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Tiranës dhe ligjeve apo rregulloret specifike që kanë të bëjnë me fushën e veprimit të këtij kodi.

-Pranë UT-së është ngritur Këshilli i Etikës me vendim të senatit akademik nr.43 datë 17.12.2020, i cili ka funksionuar me të njëjtën komision deri në 2023 ku pjesë e Këshillit të Etikës është shtuar një anëtar me vendimin e senatit nr.10 datë 30.01.2023. Kompetencat e Këshillit të Etikës janë përcaktuar në nenin 8 të Kodit të Etikës së UT-së, por konstatohet se nuk ka një rregullore të miratuar për funksionimin e saj kjo në kundërshtim me nenin 43, pika 12 e Statutit të UT-së.

-Në zbatim të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, deklarata e Misionit të UT është hartuar dhe miratuar në Kreun I-rë të Statutit të Universitetit të Tiranës, miratuar nga MASR me urdhërin Nr.816, datë 26.12.2018 propozuar me Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës Nr.30 datë 14.09.2018.

- Struktura organike e Universitetit të Tiranës është miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.8, datë 06.03.2018, përcjellë nga Senatit Akademik me shkresën Nr.1237/7 prot., datë 29.03.2018 për miratim Bordit të Administrimit.

-Universiteti i Tiranës ka miratuar me Vendim Nr.30, datë 22.07.2021 të Senatit Akademik është miratuar Manuali i Vlerësimit të Performacës të Personelit Akademik në UT, si dhe me Vendimin Nr.3, datë 24.01.2022 të Rektoratit të UR-së është miratuar rregullorja e vlerësimit të performancës “Mbi vlerësimin e performacës në punë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ në UT”.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të UT-së si dhe përfaqësues ligjore për anën administrative dhe financiare. Për periudhën e auditimit, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga një pjesë e fakulteteve, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese. Gjatë periudhës në vazhdim, Titullari do të marrë opinione për performancën e institucionit, nga institucione të pavarura si KLSH-ja, si dhe Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, e cila shërben si evidencë.

Parimi 3 - Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

Konstatohet se miratimi i PBA nga Senati e më pas miratimi përfundimtar nga Bordi i Administrimit në të treja vitet objekt auditimi është realizuar jashtë afatit të përcaktuar nga MASR. Gjithashtu PBA është dërguar në MAS pa kaluar etapat e miratimit sipas rradhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi dhe në fund në MAS, kjo në kundërshtim me Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49 pika c, konkretisht: “...me propozim të Senatit Akademik, Bordi Administrativ miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.”

Konstatohet se GMS nuk ka kryer mbledhjet e nevojshme për miratimin e PBA në vitet 2021 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” ku përcaktohet se GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit, ku respektohet numri i mbledhjeve gjatë vitit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike.

Për vitin 2021:

Konstatohet se në 07.06.2021 UT i dërgon fakulteteve dhe filialit shkresë për përgatitjen e PBA 2022-2024. Informacioni duhet të dërgohet brenda datës 2 korrik 2021 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më 13.07.2021 nr. 3926 prot., MARS i dërgon Universitetit të Tiranës shkresën për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024. Projektbuxheti i përgatitur duhet të dërgohet brenda datës 15.08.2021 zyrtarisht në MASR dhe përmes E-mail. Më 13.08.2021 Universiteti i Tiranës dërgon PBA 2022-2024. Ku për këtë vit konstatohet se GMS nuk ka organizuar asnjë mbledhje për miratimin e PBA.

Konstatohet se Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 08.07.2021 nr. 1507/4 prot.), Instituti i Studimeve Europiane (shkresa më 12.07.2021 nr. 1507/5 prot), Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (shkresa më 30.07.2021 nr. 1507/6 prot), Fakulteti i Drejtësisë (shkresa më 30.07.2021 nr. 1507/7 prot.), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 02.08.2021, nr. 1507/8 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2022-2024 jashtë afatit 02.07.2021 si është përcaktuar në shkresën e Rektoratit dërguar më 07.06.2021.

Konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë nuk ka dërguar informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë shkresore.

Më 25.11.2021, me Vendimin nr.35 Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2022-2024 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.53 datë 26.11.2021 miratohet nga Bordi i Administrimit.

Për vitin 2022:

Më 27.05.2022, nr.1629 prot., Universiteti i Tiranës i dërgon njërive shkresën për përgatitjen e PBA 2023-2025. Informacioni duhet të përcillet brenda datës 1 Korrik 2022 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më 13.07.2022 nr. 4692 prot., MAS i dërgon UT shkresën për përgatitjen e PBA 2023-2025 me afat 20.08.2022. Më 16.08.2022 nr.1629/9 prot., Universiteti i Tiranës i përcjell MAS PBA-në brenda afatit.

Gjithashtu në këtë vit nuk është organizuar asnjë mbledhje për miratimin e PBA. Konstatim: Fakulteti i Shkencave Sociale (shkresa më 07.07.2022, nr.559/6 prot), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 12.07.2022, nr. 907/1 prot.), Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (shkresa më 13.07.2022, nr.486/2 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2023-2025 janë afatit 01.07.2022.

Konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Drejtësisë nuk kanë përcjellë informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë shkresore.

Më 30.09.2022, me Vendimin nr.25 Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2023-2025 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.50 datë 14.10.2022 miratohet nga Bordi i Administrimit.

Për vitin 2023:

Më 14.06.2023, nr.1749 prot., Universiteti i Tiranës i dërgon njërive shkresën për përgatitjen e PBA 2024-2026. Informacioni duhet të përcillet brenda datës 7 Korrik 2023 në mënyrë zyrtare dhe elektronike. Më 18.07.2023 nr. 4501/1 prot., MAS i dërgon UT shkresën për përgatitjen e PBA 2024-2026 me afat 20.08.2023. Më 18.07.2023 nr.4501/1 prot., Universiteti i Tiranës i përvjell MAS përgatitjen e afatit buxhetor.

GMS: Në mbledhjen e datës 10 Gusht 2023 është diskutuar mbi përgatitjen e materialit për buxhetin afatmesëm 2024-2026 të Universitetit të Tiranës, ku u miratua në parim materiali i PBA.

Konstatohet se Filiali Sarandë (shkresa më 11.07.2023, nr.124/1 prot.), Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (shkresa më 10.07.2023 nr.711/1 prot.), Fakulteti i Shkencave të Natyrës (shkresa më 19.07.2023, nr.1026/1 prot), Fakulteti i Drejtësisë (shkresa më 01.08.2023, nr. 580/3 prot.), Fakulteti i Shkencave Sociale (shkresa më 09.08.2023, nr. 370/1 prot.) kanë dërguar informacionin për përgatitjen e PBA 2024-2026 jashtë afatit 07.07.2023. Gjatë auditimit është konstatuar se Fakulteti i Ekonomisë nuk ka përcjellë informacionin për përgatitjen e PBA në mënyrë zyrtare.

Më 23.11.2023, me Vendimin nr.61, Senati Akademik kryen miratimin paraprak të PBA 2024-2026 për Universitetin e Tiranës, i cili me Vendimin nr.70 datë 19.12.2023 miratohet nga Bordi i Administrimit.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr.13 datë 10.05.2024, nga UT është paraqitur observacioni me shkresë nr.103/10 prot., datë 20.05.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Për përgatitjen dhe miratimin e PBA-së Universiteti i Tiranës ka ndjekur procedurën si më poshtë vijon: Universiteti i Tiranës i dërgon të gjitha fakulteteve dhe filialit shkresë zyrtare dhe elektronike për përgatitjen e PBA-së, kjo shkresë dërgohet brenda datës 2 korrik të çdo viti. Ndërkohë MAS dërgon shkresë zyrtare dhe elektronikisht Universitetit të Tiranës për përgatitjen e PBA-së, duke përcaktuar dhe datën për dërgimin e saj në MAS. Të gjitha fakultetet dërgojnë zyrtarisht dhe elektronikisht PBA-në në Rektorat, dhe Rektorati përgatit PBA-në dhe e dërgon zyrtarisht dhe elektronikisht në MAS brenda afatit të përcaktuar. Periudha për përgatitja dhe miratimin e PBA-së korespondon me përfundimin e vitit akademik dhe është periudhë pushimesh, duke qene se anëtarët e Senatit Akademik- të UT-së janë personel akademik, është disi e vështirë për të kryer mbledhje për miratimin e PBA-së . Miratimi i PBA-së në organet kolegjiale të UT-së është miratuar pas muajit shtator dhe në vazhdim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet, konkludon se argument juaj nuk paraqet nje fakt të ri, për këtë arsye observacioni nuk pranohet.

Parimi 4 -Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësive.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohen dosjet personale, të cilat kanë pasur disa mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë, por janë plotësuar nga subjekti. Me vendimin nr.2, datë 24.01.2022 të Rektoratit të UT-së është miratuar Manuali “Për punësimin e personelit në UT”. Rekrutimi i punonjësve bëhet sipas këtij manuali.

Me vendimin e Bordit të Administrimit nr.8 datë 06.04.2021 ”Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 për Universitetin e Tiranës” ndër të tjera miratohet numri i planifikuar i punonjësve sipas formularit nr.4 bashkëlidhur vendimit.

Me vendimet nr.48 datë 26.11.2021 dhe nr.49 datë 26.01.2021 të Bordit të Administrimit të UT janë miratuar disa ndryshime në strukturën organizative të Fakultetit të Ekonomisë.

Me vendimin e Bordit të Administrimit nr.12 datë 07.04.2022 ”Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 për Universitetin e Tiranës” ndër të tjera është miratuar numri i planifikuar i punonjësve sipas formularit nr.4 bashkëlidhur vendimit.

-Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Universiteti i Tiranës për periudhën e auditimit është ngritur struktura e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimet në kuadër të përmbushjes së objektivave, misionit dhe veprimtarisë së tij. Janë zhvilluar seminare trajnues me temë “Etika në vendin e punës dhe menaxhimi i konfliktëve të ndryshme”, në fushën e etikës dhe inteligjencës emocionale, me qëllim përmirësimin ndërmjet palëve të UT-së. Janë realizuar disa trajnime në fushën e prokurimeve si dhe fushën e financës. Në përgjigje të nevojave të njësive përbërse të UT-së të identifikuar janë organizuar trajnime me

temë “Menaxhimi i Performancës dhe Motivimi i Burimeve Njerëzore”; “Përmirësimi i Aftësive Komunikuese dhe Ndërpersonale” etj.

-Trajnime për menaxhimin financiar dhe kontrollin janë zhvilluar vetëm për punonjësit e Drejtorisë së Financës.

-Universiteti i Tiranës nuk ka Komitet Auditimi të ngritur.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se UT ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale në dokumentin e rregullores së brendshme.

-Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

-Për vitin 2021, ka funksionuar GMS e ngritur me udhër të brendshëm të titullarit me nr.19, datë 23.12.2013 i cili ka funksionuar deri në nëntor të vitit 2022.

-Për vitin 2022 dhe 2023, Titullari i UT ka nxjerrë Urdhrin nr. 25 datë 02.11.2022 “Për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik të Universitetit të Tiranës”. Në këtë urdhër është ngritur GMS me 11 anëtarë dhe Kryetar grupi është Titullari i UT-së.

Gjatë auditimit konstatohet se Universiteti i Tiranës për vitin 2021 nuk ka zhvilluar asnjë takim të grupit të GMS.

Ndërkohë për vitin 2022 në datën 20.12.2022 është zhvilluar vetëm një takim me tematikën mbi përgatitjen për buxhetin e konsolidua të vitit 2023, miratimin e listës emërore të kategorive përjashtimore për listën e bursave të studentëve për vitin akademik 2022-2023, ky takim është i dokumentuar me procesverbal.

Për vitin vitin 2023 janë zhvilluar 2 takime të GMS. Një prej tyre i datës 10.08.2023 ku tematik e saj ka qenë përgatitja e materialit për buxhetin afatmesëm 2024-2026 për UT dhe takimi datës 22.09.2023, për përgatitjen e materialit për veprimtarinë financiare dhe akademike për vitin 2022-2023 për Universitetin e Tiranës. Të dyja këto takime janë të dokumentuara.

-Bazuar në Udhëzimin Nr.16, datë 20.07.2016 ‘Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike’ përcaktohet se, GMS duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit, ku respektohet numri i mbledhjeve gjatë vitit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike. Konstatohet se për të treja vitet nuk është respektuar numri i mbledhjeve të GMS.

#### - **Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se ‘Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.’

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se UT nuk ka hartuar një strategji rrisht për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.

Konstatohet se e vetmja strategji rrisht është e miratuar me shkresën nr.3488/1 prot., datë 20.01.2014 dhe nuk ka më një azhurnim të saj.

Gjithashtu, konstatohet se UT për periudhën 2021-2023 nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar’ ku përcaktohet se ‘Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë’.

Për periudhën 2023-2025 është dërguar rektoratit me shkresën nr.70/2 prot., datë 01.02.2023 miratimi i regjistrit të riskut të UT-së.

UT nuk disponon asnjë procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk. Panvarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Universiteti i Tiranës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.

Për sa është trajtuar në akt konstatim nr.13 datë 10.05.2024, nga UT është paraqitur observacioni me shkresë nr.103/10 prot., datë 20.05.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në zbatim të Ligjit Nr.10296 datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar”; Udhëzimit Nr.28 datë 15.12.2011 “ Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, Udhëzimit Nr. 16 datë 20.07.2016 “ Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar, kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; është miratuar nga Administratori i UT-së Regjistri i Riskut për Universitetin e Tiranës për periudhën 2023-2025, është miratuar me shkresën nr. 70/2 datë 01.02.2023. Ky regjistër do të përditësohet për periudhën në vazhdim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit lexoi me vëmendje gjithë parashtrimet, konkludon se argument juaj nuk paraqet nje fakt të ri, për këtë arsye observacioni nuk pranohet.

**Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve**

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Universiteti i Tiranës nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi. Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

**I. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”**

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 10 – Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 – Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 – Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikave, procedurat dhe përgjegjësitë)

duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga Nëpunësi Autorizues (NA) dhe Nëpunësi Zbatues (NZ), pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Për prokurimet nga NA për 3 vitet objekt auditimit janë miratuar urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit të prokuruar.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planifikimit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë kur ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet, të vulosura nga dega e Thesarit etij.

Personat përgjegjës për hartimin e Pasqyrave Financiare (PF) si detyrë funksionale e ka specialisti i financës dhe këto pasqyra financiare vjetore nënshkruhen nga NA dhe NZ.

Çdo muaj kryhet kontrolli dhe akordimi me Degën e Thesarit i shpenzimeve dhe arkëtimeve. Të dhënat regjistrohen nga specialisti kontabilitetit dhe i të ardhurave, kontrollohen nga NA dhe NZ.

-Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

### **Për vitin 2021:**

Titullari i UT me urdhër nr.2767 i datës 20.10.2021 ka ngritur grupin për inventarizimin e aktiveve, me urdhër nr.2767 datë 20.10.2021 ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve dhe po atë datë me urdhër nr.2767/3 është ngritur komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktieve.

Për vitin 2022:

Titullari i UT me urdhër nr.3291 i datës 01.12.2022 ka ngritur grupin për inventarizimin e aktieve, por konstatohet se nuk ka gjurmë dokumentacioni nëse është ngritur komisioni i vlerësimit të aktieve dhe komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve.

Për vitin 2023:

Konstatohet se për vitin 2023 nuk ka gjurmë dokumentacioni për inventarizimin e aktiveve kjo në kundërshtim me pikën 74 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2021, i ndryshuar.

Parimi 11 - Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

Titullari i Universitetit të Tiranës ka miratuar “Rregulloren për Funkcionimin e Sistemit Informatik në Universitetin e Tiranës”. Kjo rregullore shtrin të gjithë efektet e saj në të gjithë veprimtarinë administrative, mësimore dhe financiare të UT. Ajo vihet në shërbim të të gjithë punonjësve të UT, të studentëve, dekantave dhe Rektoratit të UT, të cilët aplikojnë Sistemin Informatik të UT në punën e tyre.

Parimi 12 – Njësia Publike vendos aktivitetet kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-UT i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar.

-Universiteti i Tiranës nuk ka plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut për aktivitetin e kontrollit.

## **II. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”.**

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.

Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 13 – Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 – Komunikimi i brendshëm

Parimi 15 – Komunikimi i jashtëm

Parimi 13 - Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në vijim të auditimit, rezulton se Universiteti i Tiranës i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit.

-Universiteti i Tiranës ka një sistem komunikimi dhe raportimi , si brenda dhe jashtë institucionit por ky sistem i raportimit nuk jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas programeve dhe projekteve.

Parimi 14 - Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalët e mbledhjeve u komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Në faqen zyrtare të institucionit pasqyrohen vendimet dhe projektet e bashkisë.

-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave apo në rrugë elektronike sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Universiteti i Tiranës është në marrëdhënie ndërvepruese të përditshme, duke përcjellë informacione të ndryshme në rrugë zyrtare, në format shkresor apo në rrugë elektronike nëpërmjet aksesit në adresat zyrtare të e-mailit.

### **III. Komponenti: "Monitorimi".**

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:

Parimi 16 – Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe/ose të veçanta;

Parimi 17 – Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave.

-Universiteti i Tiranës monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

Njësia e Audit të Brendshëm është ngritur me Vendimin e Bordit të Administrimit nr.39 datë 04.04.2018 dhe vazhdon të funksionojë po e njëjta.

Për vitet objekt auditimi, kjo njësi nuk ka funksionuar me numër të plotë sipas organikës, pasi nuk është bërë plotësimi i vendeve vakante, përkatësisht me një auditues.

Programi i Sigurisë të Cilësisë të DAB në UT për vitet objekt auditimi, është hartuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit të UT me Vendim nr.18 datë 28.05.2020. Konstatohet se nuk ka një shkresë përcjellëse të Programit të Sigurimit të Cilësisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

NJAB nuk ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar.

-Universiteti i Tiranës nuk ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Titullari i njësisë informohet në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e rekomandimeve.

Parimi 17 - Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

## **2.4. Vlerësimi i komponentëve të auditit të brendshëm.**

### *- Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm.*

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në UT është pjesë e strukturës administrative të Rektoratit të Universitetit të Tiranës (UT), por është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit të Universitetit. Në UT ka qenë në fuqi struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Rektoratin e UT sipas vendimit të Bordit të Administrimit të UT me nr. 39 datë 04.04.2018 dhe është i pandryshuar deri në vitin raportues.

### *- Organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, niveli i kualifikimit.*

Auditimi i brendshëm në UT ka funksionuar në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", VKM nr.83 datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njesisë së Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik", si dhe manualit të auditimit i miratuar me urdhër të MF- nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik" ndryshime. Përveç këtyre akteve, në punën audituese, kanë shërbyer edhe ligje, udhëzime e manuale e metodika të tjera specifike për arsimin e lartë.

Gjatë viteve objekt auditimi, i gjithë stafi i DAB ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vijueshëm të edukimit të përditësuar të organizuar dhe zhvilluar nga NJQH/AB. Nga ana e stafit të cilët kanë qenë të certifikuar janë ndjekur trajnimet e detyrueshme 40 orë në vit të organizuara nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, këto trajnime janë ndjekur me interes nga audituesit e drejtorisë.

Struktura e miratuar është si vijon:

Nr.	Nga 01.01.2021 deri më 31.12.2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Datë fillimi dhe mbarimi
1	I.K	Drejtores	Ekonomik	30	20	2006	40	2004-
2	B.K	Përgjegjës Sektori	Financë-Kontabilitet	24	9	2021	40	2018-
3	S.M	Specialist	Financë-Kontabilitet	42	14	2009	40	2008- 31.12.2023
4	E.Z	Përgjegjës Sektori	Financë-Kontabilitet	20	13	2013	40	2018-
5	V.N	Specialist	Ekonomi dhe politika agrare	20	4	2013	40	2021-
6	E.XH	Specialist	Ekonomik	7	3	2023	40	2021-

### *- Analiza e Kapaciteteve të Audituesve.*

Në realizimin e misionëve të parashikuara, Njësia e Auditimit të Brendshëm është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njesisë së auditimit në nivel drejtorie në UT, i përbërë nga 6 (gjashtë) auditues dhe 1 (një) drejtuesi i kësaj njësie.

Në bazë të strukturës dhe numrit të punonjësve, nivelit të riskut për çdo sistem, është bërë edhe përcaktimi numrin të ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuara për këtë periudhë.

Për vitet objekt aditimi, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, nuk ka funksionuar me numër të plotë sipas organikes, pasi nuk është bërë plotësimi i vendeve vakante, përkatësisht me një auditues. Aktualisht Drejtoria e Auditimit të Brendshëm funksionin me 6 (gjashtë) punonjës. Gjatë auditimit u konstatua se për vitet objekt auditimi struktura në DAB është e paplotësuar me 1 (një) punonjës më pak.

## ***2. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.***

Karta e Auditimit është përgatitur nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm dhe miratuar nga Bordi i Administrimit, me vendimin nr. 124 datë 17.07.2019 dhe nr. 3458 Prot., datë 23.07.2019 dhe nuk ka pasur ndryshime për sa i përket viteve të objekt auditimit.

Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave. Programi i Sigurimit të Cilësisë të D.A.B në UT për vitet e program auditimit, është hartuar dhe miratuar nga Bordi i Administrimit të UT me Vendim Nr. 18, nr. 2832 prot., datë 28.05.2020.

- *Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, në UT, për periudhën nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2023 është raportuar në mënyrë sistematike, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti, si më poshtë:*

1. Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023. Me vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 42 dhe nr. 3031 Prot., datë 20.10.2020, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 2816/1 prot., datë 20.10.2020 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2021-2023 dhe vjetor 2021 të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2021 i bashkangjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani. Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt.

2. Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2022-2024, Me vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 41 dhe nr. 2356/1 Prot., datë 25.10.2021, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor. Me shkresën nr. 2356/2 prot., datë 25.10.2021 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2022-2024 dhe vjetor 2022 të veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2022 i bashkangjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.; Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt. Plani strategjik dhe vjetor është dërguar në MFE me 5 ditë vonesë jo në përputhje me MAB por nuk është një fenomen i përsëritur.

3. Plani strategjik dhe vjetor i veprimtarisë së Auditimit të brendshëm për periudhën 2023-2025, Me vendimin e Bordit të Administrimit me nr. 51 dhe nr. 2515/1 Prot., datë 20.10.2022, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në

“Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 2515/2 prot., datë 20.10.2022 ka dërguar MFE planin strategjik për vitin 2023-2025 dhe vjetor 2023 të veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Plani strategjik përgjithësisht është hartuar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3. Plani vjetor për vitin 2023 i bashkëngjitur me planin strategjik, është hartuar bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2 dhe 3.3., ku në përmbajtje të tij janë të përshkruara të gjitha pikat e strukturës së këtij plani.; Plani strategjik i veprimtarisë është bazuar në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve për secilin subjekt.

4. Raportimi vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2021, në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është kryer me shkresën nr.479 prot, datë 15.02.2022, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.3.

5. Raportimi vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2022 në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është kryer me shkresën nr. 185/1 prot, datë 15.02.2023, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.3.

6. Raportimi vjetor i veprimtarisë së AB për vitin 2023 në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm me shkresën nr.427/1 prot, datë 15.02.2024, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat, shoqëruar edhe me pjesën përshkruese të raportit, i përgatitur në përgjithësi sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.3.

### **3. Përshkrimi i situatës mbi aktivitetin e DAB.**

Bazuar në strukturën e UT, të gjitha subjektet që auditon DAB janë të gjitha institucione arsimore në varësi të UT, të cilat nuk kanë në përbërje të strukturës dhe organikës së tyre një njësi të auditimit të brendshëm dhe për këtë arsye janë identifikuar të gjitha institucionet e varësisë si subjekte auditimi, sepse shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga struktura e DAB në UT. Shpërndarja e subjekteve të identifikuara për auditim gjatë viteve objekt auditimi është bërë duke marrë në konsideratë nivelin e vlerësimit të riskut, përlllogaritjen e burimeve të auditimit si dhe frekuencën e auditimit.

Institucionet e varësisë së UT janë gjithsej 10 (dhjetë), të cilat janë si: *1-Rektorati; 2-Fakulteti i Drejtësisë; 3-Fakulteti i Ekonomisë; 4-Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; 5-Fakulteti i Histori Filologjisë; 6-Fakulteti i Shkencave të Natyrës; 7-Fakulteti i Shkencave Sociale; 8-Filiali Sarandë; 9-Instituti i Studimeve Evropiane; 10-Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.*

Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme sipas viteve objekt auditimi si dhe rekomandimet e dhëna, ta detajuar sipas *Aneksit nr. 1/1 bashkëlidhur RPA.*

#### *- Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.*

Planifikimi i një angazhimi auditimi nga njësia e auditit të brendshëm në UT është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi”, duke ndërmarrë të gjitha hapat për fillimin e punës nga ana e grupit të auditimit, si : Autorizimi për fillimin e auditimit, njoftim paraprak për fillimin e angazhimit, takimi fillestar, deklarata e pavarësisë, ndarja e detyrave, vlerësimi i riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit

dhe për sistemet/fushat e veçanta të llogarisë, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Vlerësojmë se në mbështetje të Manualit të AB, miratuar me Urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016 (i ndryshuar), programet e auditimit kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit, në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

- Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit

Nga DAB, në UT janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese, (dokumentimi) i saj. Kjo strukturë ka plotësuar pyetësorin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kap. II të MAB. Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, veprime të cilat përputhen me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, (i ndryshuar). Nga auditimi i projekt - raporteve dhe raporteve përfundimtare, rezulton se nga audituesit e brendshëm në procesin e auditimit, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe formë. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Praktikat e përzgjedhura për shqyrtim dhe vlerësim janë të plota në dokumentacion dhe përmbajnë auditime të kryera gjatë periudhës 2021-2023, në subjektet, si më poshtë:

- *Fakulteti i Drejtësisë (viti 2021, auditim për periudhën 01.01.2018-31.12.2020)*
- *Fakulteti i Shkencave të Natyrës (viti 2021, auditim për periudhën 01.01.2018-31.12.2020)*
- *Rektorati Universiteti i Tiranë (viti 2021, auditim për periudhën 15.06.2015-31.12.2019)*
- *Instituti i Studimeve Evropiane (viti 2021, auditim për periudhën 01.01.2017-31.12.2020)*
- *Fakulteti i Gjuhëve të Huaja (viti 2022, auditim për periudhën 01.01.2019-31.12.2020)*
- *Fakulteti Ekonomik (viti 2022, auditim për periudhën 01.01.2019-31.12.2021)*
- *Fakulteti i Shkencave Sociale (viti 2022, auditim për periudhën 01.01.2019-31.12.2020)*
- *Filiali Sarandë (viti 2023, auditim për periudhën 01.01.2021-31.12.2022)*
- *Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (viti 2023, auditim i periudhës 01.01.2021-31.12.2022)*

**Konstatim:** Nga dosjet e marra në shqyrtim rezulton se në pjesën më të madhe të tyre, vihet re se projekt raportet dhe raportet përfundimtare, pasi janë përgatitur dhe përfunduar nga ana e njësisë së auditimit, ju janë dërguar për miratim Bordit të Administrimit, i cili ua ka përcjellë subjekteve të audituara këto projekt raporte në tejkalim të afatit, veprim ky në mospërputhje me përcaktimet e pikës 4.1.12, kapitulli nr. IV të MAB dhe me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe pika 4.1.12, kapitulli IV i Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar; e cila ka sjellë mos dërgimin në kohë të raporteve.

- Gjithashtu dosja e përhershme e auditimit, nuk është krijuar manualisht ose elektronikisht, veprim ky në mospërputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

-Dosjet e auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e institucionit, por mbahen në ambientet e brendshme të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në mospërputhje me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar dhe Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, e cila ka sjellë mos arkivimin e dosjeve në zbatimin e ligjit dhe mos krijimin e dosjes së përhershme të auditimit.

#### - **Për vitin 2021**

Sipas programit vjetor 2021, janë planifikuar 6 misione auditimi dhe janë realizuar 6 prej tyre. Auditimet janë të gjitha të kombinuara. Subjektet e audituara janë: Rektorati, Instituti i Studimeve Evropiane, Filiali Sarandë, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Njësia e auditit të brendshëm bazuar në vlerësimin e risqeve kryesore të veprimtarisë së subjekteve ka audituar sistemet si më poshtë:

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i programit dhe zbatimit të buxhetit, sistemi i krijimit dhe përdorimit të ardhurave dytësore, sistemi i pagesave, sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemi i auditimit të bursave për studentët përfitues, sistemi i auditimit të mbingarkesave mësimore, të personelit akademik.

Për periudhën raportuese janë konstatuar parregullsi në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagave, në sistemet e ligjshmërisë në lidhje me marrëdhëniet e punës, në sistemet e kontabilitetit, në sistemet e rregullshmërisë së mësimdhënies, në sistemet e buxhetit mbi të ardhurat, në sistemet e mbledhjeve të tarifave të shkollimit, në sistemet e arkëtimeve nga të tretë dhe të tjera ku për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

#### - **Për vitin 2022**

Sipas programit vjetor 2022, janë planifikuar 5 misione auditimi dhe janë realizuar 5 prej tyre. Auditimet janë të gjitha të kombinuara. Subjektet e audituara janë: Fakulteti i Histori Filologjisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Sociale, Instituti i Studimeve Evropiane.

Njësia e auditit të brendshëm bazuar në vlerësimin e risqeve kryesore të veprimtarisë së subjekteve ka audituar sistemet si më poshtë:

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i programit dhe zbatimit të buxhetit, sistemi i krijimit dhe përdorimit të ardhurave dytësore, sistemi i prokurimeve të fondeve publike, sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemi i auditimit të bursave për studentët përfitues, sistemi i auditimit të mbingarkesave mësimore, sistemi mbi procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, sistemi i zbatimit të procedurave sipas kuotave të miratuara dhe realizimi i mbledhjes së tarifave të shkollimit sipas cikleve të studimit.

Për periudhën raportuese janë konstatuar parregullsi në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagave, në sistemet e ligjshmërisë në lidhje me marrëdhëniet e punës, në sistemet e arkëtimeve nga të tretë dhe të tjera ku për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

#### - **Për vitin 2023.**

Sipas programit vjetor 2023, janë planifikuar 5 misione auditimi dhe janë realizuar 5 prej tyre. Auditimet janë të gjitha të kombinuara. Subjektet e audituara janë: Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Filiali Sarandë, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Rektorati UT. Njësia e auditit të brendshëm bazuar në vlerësimin e risqeve kryesore të veprimtarisë së subjekteve ka audituar sistemet si më poshtë:

- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, sistemi i programit dhe zbatimit të buxhetit, sistemi i krijimit dhe përdorimit të ardhurave dytësore, sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve të fondeve publike, sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar, sistemi i auditimit të bursave për studentët përfitues, sistemi i auditimit të mbingarkesave mësimore, sistemi mbi procedurat e administrimit të projekteve të kërkimit shkencor, sistemi i zbatimit të procedurave sipas kuotave të miratuara dhe vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Për periudhën raportuese janë konstatuar parregullsi në sistemin e prokurimeve, në sistemin e mbledhjeve të tarifave të shkollimit dhe të tjera ku për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2021, është hartuar dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 871/5 Prot., datë 20.04.2022. Bashkëngjitur tij dhe raporti përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin subjekt i auditimit si dhe ju është përcjellë dhe subjekteve përkatëse. Dosja është e plotë dhe përmban të gjithë dokumentet përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2022, është hartuar dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 1678/8 Prot., datë 18.04.2023. Bashkëngjitur tij dhe raporti përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin subjekt i auditimit si dhe ju është përcjellë dhe subjekteve përkatëse. Dosja është e plotë dhe përmban të gjithë dokumentet përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve për vitin 2023, është hartuar dhe është dërguar në MFE me shkresën nr. 1013/11 Prot., datë 11.04.2024. Bashkëngjitur tij dhe raporti përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve për secilin subjekt i auditimit si dhe ju është përcjellë dhe subjekteve përkatëse. Dosja është e plotë dhe përmban të gjithë dokumentet përkatëse në përputhje me Ligjin nr. 114/2015, për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm.

*Nga subjekti UT, nuk janë paraqitur kundërshti në fazën e projektraport auditimit mbi pikën për veprimtarinë e AB.*

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi përgatitjen dhe miratimin e PBA evidentohet se miratimi i PBA nga Senati dhe nga Bordi i Administrimit në të tre vitet subjekt auditimi (2021 -2023) është realizuar jashtë afatit të përcaktuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. Gjithashtu PBA është dërguar në MAS pa kaluar etapat e miratimit sipas radhës kronologjike të përcaktuar me ligj, si në Senatin Akademik, GMS, Bordi-n e Administrimi dhe në fund në Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, në kundërshtim me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49 pika (c). GMS nuk ka kryer mbledhjet e nevojshme për miratimin e PBA në vitet 2021 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” . (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Organet Drejtuese të marrin masa për miratimin e PBA brenda afateve të përcaktuara dhe respektimin e radhës kronologjike dhe hierarkike të miratimit nga UT fillimisht si nga Senati, GMS, Bordi i Administrimit e së fundmi në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit, konstatohet se është i pranishëm risku i parashikimeve të pabazuara të cilat reflektohen në përqindje të ulët realizimi. Në vitin 2023 niveli i realizimit të shpenzimeve të llogarisë 602 “*Shpenzime Operative*” është 76%, në vitin 2023 niveli i realizimit të shpenzimeve të llogarisë 606 “*Transferta familjare dhe individë*”.

– Bursa” është në masën 71%, në vitin 2021 niveli i realizimit të shpenzimeve të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” është realizuar në masën 1,6%. Kjo tregon mungesë eficence në arritjen e objektivave të miratuara për UT. Gjithashtu të pranishme janë dhe rialokimet të cilat evidentohen vit pas viti dhe granti i trashëguar. Nga viti 2021 kanë pasur grant të trashëguar të gjitha njësitë, përveç ISE, IFBZ dhe Institutit Konfuci. Nga viti 2022 grant të trashëguar kanë pasur të gjitha njësitë, përveç Institutit Konfuci.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr.9963 datë 26.08.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” të ndryshuar, neni 3, pika 29. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Universiteti i Tiranë të marrë masa që strukturat përgjegjëse për programimin dhe planifikimin buxhetor të kryejnë analizat e nevojshme për një buxhet të suksesshëm, duke patur parasysh nevojat reale gjatë vitit buxhetor.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi shpenzimin e fondeve të krijuara nga të ardhurat dytësore (kap. 6) grupi i auditimit konkludon se ka një realizim mesatar në masën 44,3%, ku zërat me realizimin më të ulët janë artikulli 602 “*Shpenzime Operative*”, në vitin 2021 realizim 40%, në vitin 2022 realizim 39%, në vitin 2023 ka realizim prej 44%. Artikulli 231 “*Investime*” me realizim 20% në vitin 2021, 33% në vitin 2022 dhe 16% në vitin 2023. Gjithashtu, të ardhurat e trashëguara nuk janë përdorur me eficiencë dhe për vitet respektive, konkretisht: janë shfrytëzuar për vitin 2021 vetëm 38% e tyre, në vitin 2022 janë përdorur 50% e të ardhurave dhe në vitin 2023 janë përdorur 53% e tyre.

Këto konkluzione vërtetojnë mosvënien në përdorim të të ardhurave të realizuara nga UT dhe mungesën e një analize të saktë dhe efektive ekonomike mbi shfrytëzimin e fondeve për nevojat e institucionit, në kundërshtim me Ligjin nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, neni 118. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Universiteti i Tiranë në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, të marrë masa për:

- Planifikimin e përdorimit të të ardhurave për nevojat e institucionit në shërbim të mësimdhënies dhe rritjes së cilësisë së arsimit si dhe mbështetjen e kërkimit shkencor.

- Vënien në përdorim të të ardhurave të mbartura, për zhvillimin e mëtejshëm të UT dhe realizimin e misionit të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza dhe vlerësimi i të dhënave mbi rezultatet e Kërkimit Shkencor, rezulton se përqindja e realizimit për kategoritë e fondeve të shpenzuara në të tre vitet

ka një mesatare prej 39%, Problematikat më të mëdha gjenden në kërkimin shkencor të financuar nga të ardhurat, ku për vitin 2021 ka një realizim prej 39%, në vitin 2022 29% dhe në vitin 2023 30%. Gjithashtu vihet re se nga të ardhurat, për vitin 2021, 38% e llogarisë 602 është parashikuar për këtë funksion, në vitin 2022, 32% e llogarisë 602 për kërkimin shkencor. Ndërsa nga granti 9% është parashikuar për kërkimin shkencor në vitin 2021 dhe 6% në vitin 2022, veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 9963 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, neni 4, Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 1 pika a. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Rektori i UT në bashkëpunim me Senatin Akademik, Bordin e Administrimit si dhe strukturat e tjera përgjegjëse të marrë masat e nevojshme për analizimin, nxjerrjen e përgjegjësive dhe realizim të treguesve të planifikuar e të miratuar të buxhetit për fushën e Kërkimit Shkencor, duke e konsideruar si një fushë prioritare për UT.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarive vjetore viti 2023, rezulton se lidhur me gjendjen e debitorëve të paraqitur në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nga ana e Rektoratit dhe Universitetit të Tiranës, nuk janë marrë masat për një vlerësim real dhe të besueshëm për gjendjen e debitorëve të krijuar nga vitet 2010-2018, në vlerën 4,321,625 lekë.

Mangësitë e mësipërme sjellin kalimin i afatit të parashkrimit të detyrimeve të arkëtueshme për shkak të moszbatimit të kuadrit ligjor për mbledhjen e detyrimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”, pika 3, germa “g”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandim:** Administratori i UT në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe atë Juridike, të marrin masa për të siguruar arkëtimin e debitorëve të trashëguar me vite në vlerën **4,321,625 lekë**. Për debitorët pa shpresë arkëtimi të verifikohet dhe evidentohet realisht statusi apo mundësia për arkëtim të detyrimit dhe më pas të bëhet sistemimi i tyre në kontabilitet me qëllim paraqitjen sa më të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të Institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi administrimin e pronave të UT, rezulton se:

Me VKM nr. 430, datë 2.7.2014 “Për miratimin e listës së inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar janë kaluar pronat UT.

Me shkresën nr. 02/1 prot. datë 23.01.2024, Administratori i UT ka informuar Ministrinë e Arsimit se në zbatim të VKM nr. 430, datë 02.07.2014, është vijuar me procedurat për regjistrimin e pasurive në përputhje me listën e inventarit të pronave të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi UT – së, në zbatim të VKM nr.500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Nga auditimi rezultoi se UT disponon çertifikata pronësie vetëm për 5 pasuri nga 21 pasuritë e kaluara në administrim dhe për pjesën tjetër është në proces regjistrimi.

Situata e mësipërme sjell për pasojë mangësi në formalizimin e marrëdhënies së institucionit me asetet e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, për shkak të mungesës së disponimit të titujve të pronësisë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim VKM nr.500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar pika 2 dhe 9.

Gjithashtu, konstatohet se nga ana e institucionit nuk janë kryer rivlerësime të asetëve me qëllim për afrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin sikurse parashikohet në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”, duke sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Aktivet afatgjata në sektorin publik nevojitet të rivlerësohen me vlerën aktuale në mënyrë që Pasqyrat Financiare të japin një pamje të plotë të aktiveve që ka subjekti publik, me qëllim që përdoruesit të kuptojnë vlerën ekonomike të aktivitetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 105. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Universiteti i Tiranës (strukturat përgjegjëse), të marrin masa për përmbylljen e procedurave dhe pajisjen me certifikatat e pronësisë për godinat e regjistruara në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, me qëllim formalizmin e marrëdhënies së Universitetit të Tiranës dhe objekteve në pronësi.

**6.2 Rekomandimi:** Administratori i UT në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të parashikojnë fonde për kryerjen e procesit të rivlerësimit të asetëve nga subjekte të licencuara, me qëllim për afrimin e vlerës kontabël me vlerën aktuale të tregut për aktivin.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se komisioni i vlerësimit të aktiveve për vitin 2021, në përbërje të tij nuk ka specialistë të fushës për të kryer procesin e vlerësimit të aktiveve të demtuara, kryesisht të pajisjeve elektronike. Komisioni për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve për vitin 2021, në proces-verbalin e mbajtur datë 30.12.2021 “për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit”, nuk ka të dokumentuar procedurën e plotë të asgjësimit të aktiveve në vlerën 40,813 lekë.

Për vitin 2022, komisioni i inventarizimit nuk ka përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për vlerësim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme drejtuesit.

Në vitin 2023 në UT nuk janë realizuar proceset e inventarizimit.

Për vitet objekt auditimi nuk është konstatuar dhe verifikuar gjendja e lëndës djegëse në cisternat e karburantit në fund të çdo sezoni të ngrohjes për secilën nga kaldajat e UT dhe nuk është pasqyruar niveli i lëndës djegëse në depozitat e kaldajave dhe gjeneratorit.

Gjithashtu komisioni për nxjerrje nga përdorimi të aktiveve për vitin 2021, në proces-verbalin e mbajtur datë 30.12.2021 “Për mallrat dhe materialet e dala jashtë përdorimit”, nuk ka dokumentuar asgjësimin e aktiveve në vlerën 40,813 lekë, në kundërshtim Ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” Neni 61, Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, rezulton se:

- Universiteti i Tiranës ka ngritur një sistem pjesërisht efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim;
- Nuk është hartuar Plani i Veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë as raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;
- Nuk është hartuar një regjistër i konsoliduar risku, dokumenti i listës (hartës) së proceseve të punës, nuk është përditësuar sipas kërkesave të parashikuara në ligj dokumenti i gjurmës së auditimit;
- Nuk është hartuar një dokument i mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, - Për periudhën e auditimit, situata paraqitet pjesërisht efektive, ajo që vlen të theksohet është mungesa e raportimeve të rregullta periodike nga një pjesë e fakulteteve, raportim i cili nuk duhet të jetë i përqendruar vetëm në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performancë dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion;
- Grupi i menaxhimit strategjik nuk ka kryer mbledhjet e nevojshme për miratimin e PBA në vitet 2021 dhe 2022, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
- Universiteti i Tiranës nuk vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe nuk kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve për shkak të mungesës së aftësisë parashikuese, angazhimit dhe ndërgjegjësimit mbi përfitimet e këtij procesi;
- Nuk ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.
- Miratimi i PBA nga Senati e më pas miratimi përfundimtar nga Bordi i Administrimit në të tre vitet subjekt auditimi është realizuar jashtë afatit të përcaktuar nga MASR. Gjithashtu PBA është dërguar në MAS pa kaluar etapat e miratimit sipas radhës kronologjike të përcaktuar me ligj, duke kaluar si fillim në Senat, GMS, Bord Administrimi dhe në fund në MAS, në kundërshtim me Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49 pika (c). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 51-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Rektori i Universitetit në bashkëpunim me Administratorin e UT, të marrin masa për:

- Hartimin e procedurave të shkruara mbi rregullat e raportimit, i cili nuk duhet të jetë i fokusuar vetëm në çështje financiare dhe buxhetore, por edhe në objektiva, tregues performancë dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva.
- Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.
- Hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, regjistrin të riskut si dhe planin e veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

### **C. MASA DISIPLINORE.**

Për punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë jo të përsëritura dhe me mangësi më të ultë se risku i parashikuar nga grupi i të auditimit, dhe lihet në kompetencë të Administratorit të UT në bashkëpunim me Bordin e Administrimit të UT, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 7961, datë

12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu IV, neni 11, shkronja “e” dhe “ç” dhe neni 37, si dhe të kontratën individuale të punës.

Për sa sipër mbahet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**